



# FLASIM SHQIP





# FLASIM SHQIP

REVISTË INFORMUESE

Botimi i kësaj reviste letrare është miratuar nga Këshilli Koordinues i Botimeve për Diasporën dhe shpërndahet falas në diasporë.

Viti II, nr. 4  
Revistë periodike

© Qendra e Botimeve për Diasporën, 2024

Drejtores:  
Mimoza Hysa

Adresa:  
Rruga "Vilat Gjermane", Vila nr. 6, Tiranë,  
Shqipëri  
info@qbd.gov.al

Bordi i revistës:  
KKAD

Kryeredaktore:  
Yllka Lezo

Përgatiti për botim:  
Qendra e Botimeve për Diasporën

4 EDITORIAL  
**GJUHA SHQIPE PËR  
DIASPORËN – SI PËRJETIM,  
TRASHËGIMI DHE MUNDËSI**  
Nga Rigels Halili

8 DRITARE  
**SEMINARI XVII**  
METODOLOGJI TË MËSIMDHËNIES SË GJUHËS  
SHQIPE DHE TË KULTURËS SHQIPTARE NË  
DIASPORË E NË MËRGATË

16 PROFIL  
**ALBA LIFE**  
**14 VITE HISTORI SUKSESI**  
Nga Yllka Lezo

22 RISI NË MËSIMDHËNIË  
**FUTBOLLI BASHKON NXËNËSIT  
SHQIPTARË NË ZVICËR**  
Nga Vaxhid Sejdiu

28 AKTIVITETE  
**REZIDENCA "FAN NOLI"**  
Nga Yllka Lezo

34 FOKUS  
**SHKOLLAT E GJUHËS SHQIPE  
NË ANGLI**  
Nga Yllka Lezo

38 INTERVISTË  
**IRIS HALILI**  
KLUBI "FLAS SHQIP" NË FLORIDA  
Nga Yllka Lezo

52 PËRVOJA DHE OPINIONE  
**GJUHA SHQIPE SI GJUHË AMTARE**  
Nga Aurela Konduri

60 PRINDI  
**UDHËTIM DYGJUHËSOR**  
Nga Teuta Tabaku

66 BASHKËBISEDIM  
**LIBRI "ALBANI NUK FLET SHQIP"**  
Nga Yllka Lezo

72 KRIJIMTARI  
**SHKRIMTARËT E VEGJËL  
TË DIASPORËS**  
Nga Mustafë Krasniqi  
Miradije Berisha  
Arta Emiri

78 NXËNËSI  
**SHKOLLAT SHQIPE NË ZVICËR**  
Nga Vaxhid Sejdiu

81 SHKOLLA  
**SHKOLLA E KURSE SHQIPE**  
Nga Yllka Lezo

84 LIBRI NË VITRINË  
**KLASIKËT DYGJUHËSH**

90 ARGËTIM  
**PROVOJMË NJOHURITË**



Nga RIGERS HALILI

# GJUHA SHQIPE PËR DIASPORËN

SI PËRJETIM, TRASHËGIMI DHE MUNDËSI

Tashmë ne, shqiptarët, jemi transformuar në një komb diasporik. Nuk është diçka e re në historinë tonë. Ka ndodhur kështu edhe më parë e shumë herë të tjera. Lëvizja dhe ngulja janë dy tipare thelbësore në procesin e gjatë historik, që solli krijimin e shqiptarëve modernë. Arsyet kanë qenë të shumëllojshme: luftërat, dëbimet, shpëtimi, vdekja, jetesa e vështirë, toka, bagëtitë, probleme të ndryshme të natyrës sociale, e vetëm rrallëherë dëshira autentike për të njohur botën përreth. Nëse e shohim historinë e shqiptarëve nga kjo pikëpamje, atëherë izolimi gjatë periudhës komuniste, edhe pse në vetvete jo plotësisht i suksesshëm, e sidomos pamundësia e lëvizjes së lirë nën hijen shpesh të dhunshme të mekanizmit të “celebrimit”, ishin fenomene krejt të pazakontë. Gjithsesi, ndër ndryshimet e shumta që pësoi shoqëria shqiptare, ose për të qenë socio logjikisht më të drejtë – tre shoqëri shqiptare me veçantitë dhe të përbashkëta e tyre në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni – rikthimi i historisë i materializuar në procesin e lëvizjeve masive njerëzore ishte ndoshta më i ndjeshmi dhe më tronditësi. Pra, edhe një herë, jemi kthyer tashmë në një komb diasporik, si gjitonët grekë, apo komshinjtë italianë, megjithëse ndoshta më pak sesa armenët dhe hebrenjtë. Këtë gjë e dëshmojnë qartë jo vetëm shifrat e statistikave zyrtare shtetërore, por mbi të gjitha e ndiejmë ne të gjithë, duke pasur vetveten apo dikë të afërm si “refugjat”, “në emigracion”, “jashtë”, “atje”, “të ikur”, “përtej

oqeanit”, “në fund të botës”....

Çdo të thotë kjo gjë? Ky realitet socio-politik, i cili përmbledhet kaq lehtë në këtë fjali të thjeshtë, është i mbushur me një kompleksitet kaq të shumëllojshëm, sa që analiza e plotë e të cilit duket gati e pamundur. Në fakt, tashmë prej vitesh shumë aspekte të tij i kanë përshkruar, apo u janë referuar atyre shkrimtarë, poetë, artistë, kompozitorë, këngëtarë, intelektualë dhe, pa dyshim, bota mediatike. Analiza e plotë e pasojave sociale, kulturore, demografike dhe ekonomike të këtij procesi diasporizimi po merr trajtën e një nëndisiplinë të mirëfilltë shkencore. E, natyrshëm, po merret me të edhe bota politike, duke iu nënshtruar më tepër logjikës së diktuar nga harku kohor katërvjeçar i të bërit të politikës sot, sesa nga nevoja e mirëfilltë për reagim, mendim, apo largpamësi.

Më tepër se gjithkund tjetër pësia e këtij procesi ndihet në gjuhë. Ata që ikën, apo po ikin, janë shqipfolës, e ata që (nuk do të) kthehen, nuk janë më shqipfolës të mirëfilltë. Nuk është vetëm ndryshim numerik, është mbi të gjitha ndryshim etnogjuhësor. Natyrisht, nuk duhet detyrimisht e thënë të jetë kështu, por praktika e këtyre tre dekadave ka treguar, se gjuha shqipe në diasporë i nënshtrohet të tjera rregullave ndryshimi nga zhvillimet e saj në vend. Ajo gjallon në të tjera kontekste sociale dhe sociologjike, e mbi të gjitha transmetohet nëpërmjet të tjera kanaleve, ku mbizotëron gjuha e folur, qoftë ajo primarja, klasikja,

pra nga brezi i gjyshërve tek ai i nipërve dhe mbesave, qoftë edhe ajo dytësorja, kryesisht nëpërmjet mediave sociale, pra gjuha e shkruar, paçka se në vështrim të parë kjo e fundit tingëllon si oksimoron.

Nëse e shohim pak më të thjeshtuar këtë çështje, e, për rrjedhojë, edhe duke bërë një përgjithësim, mund të vihen në pah tre tendenca thelbësore të shqipes sot në diasporë.

➡ *Së pari*, ajo jeton si përjetim. Kjo është gjendja e atyre që e kanë shqipen të gjallë, e përdorin në komunikimin e përditshëm, e kultivojnë në të shkruar, e kërkojnë në të lexuar, përpriqen që ajo të ruajë një gjendje konstante, në mos të zhvillohet.

➡ *Së dyti*, gjuha jeton si trashëgimi. Ajo tashmë funksionon, në mos tërësisht, atëherë kryesisht si një mjet komunikimi pasiv ose me brezat në të shkruar e sipër, apo tashmë të kaluar. Nuk është mbetje dhe as barrë, por nuk është as mjeti primar i komunikimit, që tashmë është gjuha e vendit pritës.

➡ E, *së treti*, gjuha shqipe gjallon si një mundësi. Njohja e saj është tërësisht pasive, ose e kufizuar, më tepër brenda kuadrin të dëshirave, sesa mundësive, më tepër njohje e përfytyruar brenda sferës së afeksionit dhe asaj emotive, sesa e materializuar brenda realitetit intelektual e komunikativ. Këto tre tipa të funksionimit të gjuhës, për mendimin tim, kushtëzojnë dhe përvijësojnë edhe tre strategji veprimi kundrejt shqipes

në diasporë. Nëse identifikojmë ekzistencën e stadi të përjetimit, atëherë me gjuhën, mbi gjuhën dhe për gjuhën mund të punohet nëpërmjet kanaleve tipike kulturore, pak a shumë ashtu siç veprohet edhe në vend. Thelbësor mbetet qarkullimi intensiv i dijes, asaj ekzistuese dhe asaj të krijuar rishtas në vend e në diasporë, çka i shërbejnë shkëmbimi i librave, angazhimi i shkrimtarëve, artistëve dhe intelektualëve të afirmuar nga diaspora në jetën kulturore në vend dhe popullarizimi i institucionalizuar i arritjeve të tyre. Nëse trajektorja e ndryshimit ka arritur stadin e trashëgimisë, atëherë krahas mjeteve kulturore, që me gjasë mund t'i japin asaj një drejtim të ri drejt ripërjetimit, i duhet mëshuar edhe aspektit simbolik. Lidhja me gjuhën dhe vendin mëmë kthehet tashmë në një urë simbolike, e cila shërben mbi të gjitha si bazë për qarkullim e dijes në të dyja krahët, apo e thënë ndryshe për kalimin nga komunikimi në ndërkomunikim. Ndërsa, nëse jemi në kuadrin e gjallimit të shqipes si mundësi, atëherë politikën gjuhësore duhet të jenë njëkohësisht kulturore, simbolike, por mbi të gjitha të orientuara drejt investimit, drejt tërheqjes të këtyre pasardhësve të folësve të dikurshëm drejt vendit mëmë, duke u përpjekur të kthehen në folës potencialë, paçka se me theks tjetër. Mënyrat janë të shumëllojshme, duke nisur nga shkollat verore për fëmijët, nëpërmjet simpoziumeve shkencore, e duke shkruar te forumet ekonomike të dhomave të tregtisë. Në këtë rast, diplomacia kulturore nuk është më një

NDËRSA, NËSE JEMI NË KUADRIN E GJALLIMIT TË SHQIPES SI MUNDËSI, ATËHERË POLITIKAT GJUHËSORE DUHET TË JENË NJËKOHËSISHT KULTURORE, SIMBOLIKE, POR MBI TË GJITHA TË ORIENTUARA DREJT INVESTIMIT, DREJT TËRHEQJES SË KËTYRE PASARDHËSVE TË FOLËSVE TË DIKURSHËM DREJT VENDIT MËMË, DUKE U PËRPJËKUR TË KTHEHEN NË FOLËS POTENCIALË, PAÇKA SE ME THEKS TJETËR. MËNYRAT JANË TË SHUMËLLOJSHME, DUKE NISUR NGA SHKOLLAT VERORE PËR FËMIJËT, NËPËRMJËT SIMPOZIUMEVE SHKENCORE, E DUKE SHKUAR TE FORUMET EKONOMIKE TË DHOMAVE TË TREGTISË.

përvijëzim, apo shtesë por një strategji bazë e politikës së jashtme, duke kaluar nga niveli i politikave afatmesme, tek ato afatgjata. Natyrisht, çka u paraqit më lart është vetëm një tipologji, një vështrim i teorizuar mbi situata, të cilat rrallëherë në praktikë shfaqen në këtë mënyrë. Ne që merremi përditë me gjuhën në diasporë dimë të bëjmë dallimin dhe të reagojmë. Në shumicën e rasteve i përkasim akoma brezit që shqipen e përjeton, pra brezit me të cilin bashkëpunohet për ruajtjen sa më të fortë të saj. Por shohim tashmë ardhjen e brezit tjetër, të pasuesve, për të cilët shqipja është trashëgimi. Janë fëmijët tanë. Këtij brezi u duhet dhënë kurajë, duke i treguar peshën e rrënjëve, jo në emër të megalomanisë kombëtare dhe krenarisë boshe, por për vetë faktin se origjina e tij ndikon, a mbase edhe dikton qenien e tij, kontekstet shoqërore, ku ai funksionon. Ky nuk duhet të jetë me domosdo një brez i humbur, siç dëgjohet shpesh rëndomthi. Nuk është thënë

të përsërisim shembujt e të tjerëve para nesh, mund të mësojmë nga këto gabime. Është plotësisht në dorën tonë, që brezi i dytë i shqiptarëve në diasporë të mos e humbasë njohjen e gjuhës shqipe, por ta ruajë atë si një dëshirë. E duket tashmë edhe gjallimi i brezit të tretë, që vjen tashmë i shkëputur nga gjuha aktive. Këta njerëz duhen kërkuar, duke iu dalë ballë përballë, duke i ftuar të na bashkohen, duke u treguar se shqipja nuk është vetëm ndjenjë, por edhe mundësi për zhvillim, duke e njohur atë, duke e folur, duke investuar në të, duke përkthyer vepra të autorëve shqiptarë në gjuhët e tjera përkatëse. Secili e secila prej nesh e dimë, se ku jemi dhe çfarë po bëjmë, shpesh duke pasur mundësi të kufizuara. Por nuk jemi vetëm, jemi tashmë një lëvizje, një masë njerëzish, të njohurish, miqsh. E kjo revistë dhe Qendra që e boton atë, paçka se e vogël, janë provë e qartë jo vetëm se duhet, por edhe se mund të bëjmë shumë për gjuhën shqipe në diasporë.



Nga YLLKA LEZO

# SEMINARI

## XVII

METODOLOGJI TË MËSIMDHËNIES SË GJUHËS SHQIPE DHE TË KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË E NË MËRGATË

EMËRUESI I PËRBASHKËT NË FJALËN E PËRFAQËSUESVE TË TË DY SHTETEVE ISHTE PADYSHIM INTERESI PËR RËNDËSINË E RUAJTJES SË GJUHËS DHE KULTURËS SHQIPTARE PËR BREZAT E RINJ NË DIASPORË, SI NJË ELEMENT THELBËSOR PËR FORCIMIN E LIDHJEVE ME ATDHEUN DHE TRASHËGIMINË KULTURORE.



Seminari XVII për mësimin plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë, me temë “*Metodologji të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë*”, i zhvilloi punimet këtë verë, në datat 18–21 korrik, në Prishtinë, Kosovë.

Ky takim, i organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, si dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës, përfaqëson një përpjekje të përbashkët të dy shteteve shqiptare për të forcuar dhe për të zhvilluar ruajtjen e gjuhës dhe identitetit kombëtar midis fëmijëve dhe komuniteteve shqiptare

jashtë atdheut, ndaj edhe në hapjen e këtij seminari të rëndësishëm nuk mund të mos ishin të pranishëm figura të njohura të politikës dhe të arsimit.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, në fjalën e tij përshëndetëse, u shpreh se ndihej i nderuar që gjendej para pjesëmarrësve dhe se populli i Kosovës është falënderues për ndihmën që ka dhënë diaspora për atdheun, në veçanti për çlirimin e tij.

Ministrja e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, znj. Ogerta Manastirliu, dha lajmin e mirë për finalizimin e punës për botimin e nivelit të tretë të tekstit “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”.

*“Tekstet lehtësuese të ‘Gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare’, për të cilat është punuar si për Nivelin I dhe për Nivelin II, që ne i miratuam, tashmë vijnë dhe është në finalizim e sipër brenda këtij viti edhe botimi i Nivelit III”, u shpreh ajo.*

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Republikës së Kosovës, znj. Donika Gërvalla Schwarz, duke iu drejtuar mësuesve pjesëmarrës tha: *“Përkushtimi juaj është dëshmi e qartë e lidhjes suaj të pasuar me Kosovën; se së bashku me Qeverinë e Shqipërisë dhe qeveritë e shteteve të tjera ku ka shqiptarë, përmes seminareve të tilla marrim impute të vlefshme për të kuptuar nevojat konkrete dhe sfidat me të cilat përballen mësuesit tanë në diasporë”.*

## Seminari XVII Mbarëkombëtar

### “Metodologji të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë”

Prishtinë, 1 korrik 2024



së gjuhës dhe kulturës shqiptare për brezat e rinj në diasporë, si një element thelbësor për forcimin e lidhjeve me atdheun dhe trashëgiminë kulturore.

Në ceremoninë e hapjes, dy prej kontribuesve në mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe në diasporë, z. Nuhi Gashi dhe z. Ymer Avdia, u nderuan me certifikatën e mirënjohjes nga znj. Nagavci për kontributin e tyre të vyer në këtë fushë.

Seminari u zhvillua në disa faza dhe përfshiu një numër të madh kumtesash dhe punëtorish të ndara në disa tema kryesore, që lidhen me metodologjitë e mësimdhënies, përdorimin e teknologjisë për përmirësimin e orëve mësimore, si dhe krijimin e një platforme gjithëpërfshirëse për mësuesit në diasporë.



Ministrja Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës, znj. Arbërie Nagavci, në fjalën e saj theksoi se për 17 vite me radhë mësuesit e gjuhës shqipe në botë kanë shkëmbyer përvojat e sfidat, arritjet e pengesat në këtë seminar. Zonja Nagavci po ashtu bëri të ditur se MASHTI ka intensifikuar dukshëm mbështetjen për komunitetet shqiptare në botë në shumë forma, duke përfshirë, mes të tjerash, hartimin e kurrikulave dhe teksteve të përbashkëta, organizimin e aktiviteteve të ndryshme siç është ky Seminar. Emëruesi i përbashkët në fjalën e përfaqësuesve të të dy shteteve ishte padyshim interesi për rëndësinë e ruajtjes

Një pjesë e madhe e diskutimeve u fokusua në vlerësimin e nxënësve, përdorimin e materialeve autentike dhe rritjen e bashkëpunimit midis shkollave shqiptare në vende të ndryshme të botës.



# Seminari XVII Mbarëkombëtar

## Metodologji të mësimdhënies së gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë



**Dita e parë** e Seminarit përfshiu një program kulturor-artistik të përgatitur nga Ansambli “Shota”, që i dha ngjyrimë tradicionale këtij evenimenti dhe forcoi edhe më tej ndjesinë e lidhjes me kulturën dhe traditat kombëtare.

Në ditët pasuese, pjesëmarrësit u angazhuan në diskutime të thelluara mbi temat kryesore të seminarit, të moderuara nga përfaqësuesit e dy ministrive.



Seanca e **ditës së dytë** u pasua me diskutime, të cilat u moderuan nga znj. Erida Koleci, përfaqësuese e MAS-it e Republikës së Shqipërisë, dhe znj. Feime Llapashtica, përfaqësuese e MASHTI-it e Republikës së Kosovës. Ato theksuan se qasja e re ndaj mësimdhënies duhet të përfshijë mjete moderne dhe përmbajtje të pasur për t’u

përshtatur me nevojat dhe pritshmëritë e fëmijëve shqiptarë në diasporë. Në vijim, autorja Milena Selimi prezantoi projektin “Jam shqiptar” të Qendrës së Botimeve për Diasporën, një cikël me materiale didaktike për mësimdhënien në diasporë, me udhërrëfyes të trashëgimisë kulturore për 10 qytete të Shqipërisë dhe

Kosovës. Ky projekt ka si qëllim dhe do të shërbejë për forcimin e dijeve të nxënësve në gjuhën shqipe dhe do t’i ndihmojë ata në nxënien e fjalëve të reja në gjuhën shqipe. Përgjatë prezantimit, ajo u ndal tek botimi më i fundit, “Prishtina”, duke theksuar se këta udhërrëfyes do të jenë një mik i çmuar gjatë vizitës në Shqipëri e Kosovë.

Në punëtoritë e organizuara pati trajtesa të ndryshme, përfshirë risitë teknologjike në mësimdhënie dhe sfidat që hasen nga mësuesit në diasporë për të mbajtur gjallë interesin e fëmijëve për mësimin e gjuhës shqipe.

**Dita e tretë** solli një varietet tematikash që lidhen me bashkëpunimin midis shkollave dhe mësuesve të diasporës, si dhe ndërlihdjen midis mësimin të gjuhës e kulturës shqiptare dhe asaj të vendeve pritëse. Seanca u moderua nga znj. Shqiponja Lamçe, përfaqësuese e MAS-it, Shqipëri, dhe z. Hamdi Reqica, përfaqësues i MPJD-së, Kosovë, si dhe përfshiu gjithashtu pjesëmarrjen ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës të Republikës së Kosovës.

Në **ditën e fundit**, përfaqësuesit e ministrive vlerësuan seminarin e mbajtura dhe ndanë rekomandime për zhvillime të mëtejshme, për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve arsimore në diasporë dhe ato të vendit amë.

Në përfundim të punimeve të Seminarit XVII, të gjithë pjesëmarrësit, të cilët kontribuan në



punimet e tij, u nderuan me certifikata në shenjë mirënjohjeje për punën e palodhur që bëjnë në ruajtjen dhe promovimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë. Ky Seminar është një tjetër shembull i përpjekjeve të dy qeverive shqiptare për të ruajtur identitetin dhe kulturën e kombit tonë në brezat e rinj që rriten larg atdheut, duke krijuar një urë të fortë lidhëse midis diasporës dhe Shqipërisë e Kosovës.



## REKOMANDIME NGA SEMINARI

1. Ngritja e cilësisë së mësimdhënies së mësimin plotësues në diasporë përmes njohjes, përvetësimit dhe zbatimit të metodave didaktike bashkëkohore;
2. Mundësimi i rritjes profesionale të mësuesve të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë përmes hartimit dhe zbatimit të një kalendari të qëndrueshëm e të vijueshëm trajnimesh dhe seminaresh nga institucionet përgjegjëse, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies në Shqipëri dhe në Kosovë;
3. Krijimi i mundësive për bashkëpunim me katedra, departamente të gjuhës shqipe për kualifikimin e mësuesve të mësimin plotësues në diasporë, si dhe shtimin e numrit të mësuesve të rinj në diasporë;
4. Mbështetja me materiale mësimore dhe didaktike të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mësimin e gjuhës shqipe si gjuhë e huaj në diasporë;
5. Përshtatja e materialeve mësimore me planprogramet dhe kurrikulat e vendeve pritëse;
6. Krijimi i mundësive për një fushatë informative dhe promovionale për rëndësinë dhe dobinë e mësimin të gjuhës shqipe në diasporë;
7. Mbështetja dhe organizimi i shkollave verore dhe ekskursioneve në atdhe të nxënësve të gjuhës shqipe në mërgatë;
8. Nxitja e hartimit të marrëveshjeve dypalëshe me vendet ku mësimi i gjuhës shqipe nuk është i institucionalizuar, me qëllim lehtësimin e kushteve të mësimdhënies së gjuhës shqipe në këto vende.
9. Ruajtja e traditës së organizimit të Seminarit të përbashkët të mësuesve të diasporës në të njëjtën periudhë kohore, ditët e fundit të korrikut dhe ditët e para të gushtit.
10. Krijimi i databazës së mësuesve të diasporës në institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe caktimi i një personi kontakti në MASHTI dhe një në MPJD. Kërkohej stabilitet, sepse stafi i ambasadave ndërrohet çdo 3 vjet, ku çdoherë komuniteti shqiptar në vende të ndryshme duhet të fillojë nga fillimi.
11. Identifikimi i mundësive për t'i paguar mësuesit e gjuhës shqipe në vendet ku shteti pritës nuk ofron mbështetje financiare.
12. Tekstet mësimore të niveleve të kurrikulës të ndahen fizikisht në klasë.
13. Nevojë për ndryshimin e ligjit për lejimin e pjesëmarrjes në konkurrim edhe të teksteve të hartuara nga individë/mësues (pa detyrimin vetëm për shtëpitë botuese).

## PUNËTORITË

1. *"Vlerësimi i nxënësve, faktor kyç për mësimdhënie efektive në klasat heterogjene"*, Elmira Rama.
2. *"Risi në mësimdhënien e gjuhës shqipe përmes teknologjisë në diasporë"*, Teuta Tabaku, Turqi.
3. *"Planifikimi i orës mësimore, niveli I. 'Si mund të punojmë duke praktikuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të tri grupmoshave?'"*, Lefteri Metkaj, Greqi.
4. *"Mësimdhënia dhe të nxënësve: Roli i praktikave didaktike bazuar në situata të ndryshme"*, Albana Tahiri dhe Gilberda Hadaj.
5. *"Pema ime familjare" – Krijojmë kujtime, ndërtojmë lidhje"*, Merita Avdyli, Angli.
6. *"Rëndësia e materialeve autentike dhe projektimi i tyre në mësimdhënien e gjuhës shqipe"*, Lindita Budini, Greqi.
7. *"Digjitalizimi, prezantimi i platformave interaktive dhe heterogjeniteti"*, Etleva Mançe, Gjermani.
8. *"Plan bashkëpunimi mes shkollave me nxënës arbëreshë dhe me nxënës të tjerë në diasporë"*, Ornela Radovicka, Itali.
9. *"Ndërthurja e mësimin të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare me atë të vendit pritës"*, Anita Duriçi, Zvicër.
10. *"Përdorimi i tekstit të përbashkët "Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare", niveli I (model i një ore mësimore)"*, Vaxhid Sejdiu, Zvicër.







arsim midis dy kontinenteve si shef katedre në Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, Tiranë, profesor i lëndëve inxhinierike, si dhe pedagog i kompjuterit në kolegjin “Globe Institute” në Manhatan. Bashkëthemeluese janë bashkëshortja e tij Kozeta Zylo, dhe dy vajzat: dr. Valbona Zylo Watkins dhe Klodiana Halsted.



*“Hapja e shkollës ishte një vendim shumë i rëndësishëm dhe kombëtar, pasi duke parë rrezikun e asimilimit që mijëra fëmijë në diasporë nuk flisnin gjuhën shqipe, medoemos ishte emergjente hapja e një shkolle shqipe me program pas mësimin në gjuhën amerikane”, tregon z. Qemal Zylo.*

*ndaj lindi nevoja të kishte të tilla edhe në lagje të tjera të Nju-Jorkut, si: në Brooklyn, Manhatan, Queens dhe Bronx. Ka qenë një rrugë jo e lehtë, por po aq e bukur dhe me dritë”, vazhdon rrëfimin bashkëthemeluesja Kozeta Zylo.*

Nga YLLKA LEZO

# ALBA LIFE

## 14 VITE HISTORI SUKSESI

### NË MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË

Shkolla shqipe “Alba Life”, e nderuar me titullin e lartë “Ambasador i Kombit”, ka një histori të pasur dhe domethënëse që nisi para 14 vitesh në Staten Island, New York. Pas hapjes së TV-së, më 1 shkurt të vitit 2007, bordi drejtues mori vendimin për hapjen e shkollës shqipe, e cila filloi mësimin më 15 maj 2007, në qytetin e Staten Island, New York. Themeluesi i saj është z. Qemal Zylo me një karrierë të pasur në

Shkolla e parë shqipe u hap në qytetin Staten Island duke marrë mjedise me qira në Qendrën e njohur me komunitet hebre (Jewish Community Center - JCC). Pas pak vitesh kjo shkollë i zhvilloi mësimet në shkollën publike amerikane PS: 9 në Staten Island, ku vazhdon edhe sot mësimin në gjuhën shqip.

*“Shkolla shqipe po rritej si një pluhur kozmik, vazhdimisht në numër me mësues dhe nxënës,*

Shkolla shqipe “Alba Life” e ushtron programin e saj të mësimin të gjuhës shqipe në të gjitha lagjet e Nju-Jorkut, vetëm në mjediset e shkollave publike amerikane dhe, pas Covid-it, e vazhdon dhe *online*. Programi i saj është një program serioz, kombëtar ku japin mësimin mësuese të kualifikuara, shumica e tyre të licensuara nga shteti amë dhe ai amerikan.





## PROGRAMI

Në kohën e pandemisë shkolla shqipe “Alba Life” në Nju-Jork ishte e para që filloi mësimin shqip në platformën *online* duke u bërë frymëzuese, dhe trajnoi mjaft mësues në këtë mision. Shkolla shqipe *online* në kohën e Covid-it u shtri në disa shtete të Amerikës, Kanadasë dhe në Evropë.

*“Edhe pse online, nxënësit nën drejtimin e mësuesve festuan me madhësi Ditën e Flamurit dhe Pavarësinë e Kosovës ku përshëndetën Presidenti i parë i Kosovës, prof. dr. Fatmir Sejdiu, Konsulli i Përgjithshëm i Kosovës, z. Frymëzim Isufaj, Ambasadori William Walker, diplomati i lartë amerikan si dhe kongresisti me origjinë arbëreshe Joe DioGuardi”,* tregon Qemal Zyllo.

Në program është mësimi i gjuhës shqipe, njohja me: historinë dhe kulturën kombëtare, traditat e mrekullueshme, legjendat dhe luftërat nëpër të cilat ka kaluar populli shqiptar, heroin kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeu, martirët e gjuhës shqipe, heronjtë dhe shqiptarët e famshëm, si dhe ata që kanë bërë histori në botë. Gjatë vitit akademik shkolla shqipe “Alba Life” ka krijuar traditën kulturore të festojë me koncerte, si: Ditën e Shenjtë të Flamurit Kombëtar, festat e fundvitit, Pavarësinë e Kosovës, Ditën e Shenjtë të Mësuesit, festivalin e shkollave shqipe “Alba Life”, si dhe koncertin për mbylljen e vitit akademik shkollor.



## VLERËSIMET PËR ALBA LIFE

Shkolla shqipe “Alba Life” është përshëndetur nga mjaft personalitete dhe politikanë të lartë amerikanë dhe shqiptarë të cilët e kanë vizituar duke i frymëzuar nxënësit në shkollë. Gjithashtu “Alba Life” është vlerësuar me titullin e lartë “Ambasador i Kombit”. TV dhe shkolla shqipe “Alba Life” është vlerësuar nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Washington, Ambasada e Republikës së Kosovës në Washington, Konsullata e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë në New York, Konsullata e Republikës së Kosovës në New York, si dhe nga mjaft organizata dhe personalitete shqiptare në Amerikë.

Po ashtu është vlerësuar me certifikata e mirënjohje nga senatorë e asambleistë të ndryshëm e ligjvënës amerikanë. Me rastin e 5-vjetorit është përshëndetur nga bilioneri Mikael Bloomberg, ish-kryebashkiak i New York City. Përveç disa ministrave nga vendi amë dhe senatorëve e kongresmenëve amerikanë, shkollën shqipe “Alba Life” e kanë vizituar Kryeministri i Kosovës z. Albin Kurti si dhe znj. Donika Gërvalla zëvendëskryeministre e Kosovës e shumë të tjerë.

Shkolla shqipe “Alba Life” ka pasur nderin të hapë siparin e aktiviteteve të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë në diasporë. Po kështu ka pasur privilegjin të hapë siparin e 10-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës në diasporë në vitin 2018.



Shkolla shqipe “Alba Life” është vlerësuar me titullin e lartë “Ambasador i Kombit” dhe themeluesit e saj Qemal e Kozeta Zyllo janë vlerësuar nga Presidenti i RSH-së me titullin e lartë: “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”. TV dhe shkolla shqipe “Alba Life” në vitin 2024 është vlerësuar me proklamata nga Bashkia e Nju-Jorkut. Po ashtu për punën dhe kontributin e tyre në komunitet dhe në shoqërinë amerikane ndodhen në librin historik të Senatit të Shtetit të Nju-Jorkut në Albany me rezolutë të Senatit nr. 4487, 17 prill 2018, dhënë me rastin e 10-vjetorit, rezolutë e dorëzuar nga senatori veteran amerikan Marty Golden. Vitin akademik 2023–2024 e mbylli me plot sukses ngase u vlerësua me Rezolutën 2254, datë 22 maj 2024, nga NYS Parlament, Parlamenti dhe Senati i Nju-Jorkut propozuar nga asambleisti John Zaccaro Jr.

TV DHE SHKOLLA SHQIPE “ALBA LIFE” NË VITIN 2024 ËSHTË VLERËSUAR ME PROKLAMATË NGA BASHKIA E NJU-JORKUT. PO ASHTU PËR PUNËN DHE KONTRIBUTIN E TYRE NË KOMUNITET DHE NË SHOQËRINË AMERIKANE NDODHEN NË LIBRIN HISTORIK TË SENATIT TË SHTETIT TË NJU-JORKUT NË ALBANY ME REZOLUTË TË SENATIT NR. 4487, 17 PRILL 2018, DHËNË ME RASTIN E 10-VJETORIT, REZOLUTË E DORËZUAR NGA SENATORI VETERAN AMERIKAN MARTY GOLDEN.



Senati dhe Parlamenti i shtetit të Nju-Jorkut u ngrit në këmbë për shkollat shqipe “Alba Life” Ambasador i Kombit.

“Për herë të parë në historinë e politikës amerikane dhe në institucionet më të larta qeveritare vlerësohen dhe çmohen shkollat shqipe, çka na bën të ndihemi krenarë, por edhe për Amerikën, shtëpinë tonë të dytë që na mirëpriti dhe vlerësoi punën tonë si shqiptarë”, tregon themeluesi Qemal Zylo.

Data 22 maj ishte një ditë historike për shkollat shqipe “Alba Life” Ambasador i Kombit në gjithë Nju Jorkun dhe online.

“Në këtë muaj të trëndafilave Parlamenti dhe Shteti i Nju-Jorkut duket sikur u dhuruan nga një trëndafil maji themeluesve dhe mësuesve të këtyre shkollave për mësimin e gjuhës shqipe në Nju-Jork. Mësueset dhe anëtarët e stafit që ishin pjesëmarrës në këtë ceremoni ishin: dr. Valbona Zylo, Entela Muda, Klodiana Zylo, Fatlinda

Bujcinca Gashi, Rozeta Hyseni, Mehrije Shala, Erinda Isufaj, Albana Lazri, Valon Gërbeshi. Më duhet të përmend katër mësueset që për arsye të forta nuk mund të merrnin pjesë në këtë ceremoni madhështore si: Elona Shkreta, Vjollca Skënderi, Helena Lubonja Ujkaj dhe Gresila Basha, - tregon Kozeta Zylo, - duke theksuar se këtë vit për herë të parë kanë praktikuar të marrin si asistente të mësuesve, edukatore, por dhe ish-nxënësit, si: Aida Hajri, Edona Gjediaj, Erlinda Shala, Blenda Shehu, Sarah Bandilli, Katrina Mushkolaj”.

Shkolla shqipe “Alba Life” do të vazhdojë pa u ndalur misionin e saj kombëtar me përkushtim profesional dhe pasion së bashku me mësueset për t’u mësuar fëmijëve në diasporë gjuhën shqipe, ngase frymëzohemi nga rilindësit tanë si Gjerashim Qiriazhi i cili thotë: “Do punoj për Mëmëdhenë / gjithë jetën sa të rroj / do t’i zgjoj edhe ata që flenë / kështu jetën ta mbaroj”.



Nga Vaxhid Sejdiu

# KOMUNITET

FUTBOLLI BASHKON NXËNËSIT SHQIPTARË  
NË ZVICËR

22 SHTATORI  
ISHTE NJË DITË E  
PAHARRUAR PËR  
KOMUNITETIN SHQIPTAR  
NË ZVICËR, TEKSA  
TURNEU I FUTBOLLIT  
“ZVICËR 2024”  
MBLODHI NXËNËS NGA  
SHKOLLAT SHQIPE TË  
VENDIT.



*Mësues/e të cilët u angazhuan që ky aktivitet të  
përfundojë me sukses*

Organizuar nga Lidhja e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë “Naim Frashëri”, në bashkëpunim me Unionin e Klubeve Shqiptare të Futbollit në Zvicër, ky event shënoi një festë të vërtetë me një pjesëmarrje të lartë të nxënësve të shkollave shqipe (mbi 300 nxënës) nga pikat shkollore ku zhvillohet mësimi në gjuhën shqipe Affoltern, Dällikon, Neunehof, Rüti, Uster, Pfäffikon, Volketswil, Spreitenbach, Fehraltorf, Hunzenschwil, Birr, Othmarsingen, Vevey, Zug, Windisch, Lozanë, Trübach, Niedergösgen, Sempach etj. Ishte një ditë festive e veçantë që do të mbahet mend gjatë.

Këta janë e ardhmja e mërgatës shqiptare. Pjesëmarrja e nxënësve në këtë organizim ishte e lartë, ata kishin ardhur nga të katër anët e Zvicrës për të marrë pjesë. Mbi 300 nxënës të këtyre shkollave iu gëzuan këtij takimi duke dëshmuar edhe njëherë se pikat shkollore në Fehraltorf, në Fahrweid, në Wetzikon, në Neunehof dhe Spreitenbach të mësueses Qefsere Sejdiu, pikat shkollore në Affoltern, në Regensdorf, në Dällikon, në Neunehof, në Rüti, në Uster në Pfäffikon, në Volketswil, në Spreitenbach, të mësuesit Vaxhid Sejdiu, pikat shkollore në Hunzenschwil, në Birr, në Rapperswil, në



Othmarsingen, të mësueses Nuraj Iljasi, pikat shkollore në Vevey dhe Aigle të mësueses Ardita Abazi – Elezaj, pikat shkollore të kantonit të Zug-ut nën drejtimin e mësueses Lumnije Klinaku – Neziri, pika shkollore në Windisch e mësueses Eshtrefe Nuhiu,

pika shkollore në Lozanë e mësueses Anita Duriçi, pika shkollore në Trübach e mësueses Albulena Asani si dhe pika shkollore në Sempach e mësueses Dorjana Çela janë model suksesi.

*Qindra duar duartrokasin përpara flamurit tonë kombëtar. Nxënës të shkollave shqipe duke interpretuar këngën “Xhamadani vija – vija” nën drejtimin e mësueses Qefsere Sejdiu.*

Aktiviteti filloi me këngën “Xhamadani vija – vija” ku nxënës të veshur kuq e zi me flamuj në duar, nën drejtimin e mësueses Qefsere Sejdiu shkëlqyen para syve të prindërve të tyre, duke sjell një pamje madhështore që rrallë herë ndodh në aktivitetet shkollore. Pastaj kryetari i UKSHFZ z. Feti Demolli dhe mësuesi e bashkëkryetari i LAPSH-it z. Vaxhid Sejdiu iu uruan mirëseardhjen nxënësve dhe prindërve të tyre. “E themi me plot gojën se nxënësit së bashku me prindërit e tyre kaluan një ditë festive “Shqip” në të gjitha pikëpamjet nën valëvitjen e flamurit kombëtar dhe vargjeve të këngës “Xhamadani vija – vija / është Kosova, është Shqipëria” duke sjellë një entuziazëm dhe emocion pa fund të të gjithë pjesëmarrësit” thanë organizatorët.

Në fund të turneut të gjithë fëmijëve pa dallim u dhanë medalje në shenjë falënderimi duke vlerësuar prindërit e tyre për kujdesin dhe angazhimin e rregullt ndaj gjuhës dhe kulturës kombëtare. Në të njëjtën frymë ishin edhe përfaqësuesit e Ambasadës Shqiptare z. Valon Gashi, konsulli i Republikës së Kosovës z. Vigan Berisha, drejtori i TV “Syrin” z. Musli Saiti, dhe z. Riza Demaj, të cilët bashkërisht u bënë thirrje të gjithëve të angazhohen në sensibilizimin e prindërve të tjerë, që edhe ata të bëhen pjesë e shkollave shqipe në Zvicër. Në këtë ditë fusha e sportit në Niderlenz të Zvicrës ishte e mbështjellë kuq e zi, me ngjyrat e flamurit tonë kombëtar, dhe nxënësit e shkollave shqipe ishin veshur sipas



*Qindra prindër pjesëmarrës që kishin ardhur së bashku me fëmijët e tyre në turneun e futbollit*



*Këta janë e ardhmja e mërgatës shqiptare. Fëmijë të cilët vijojnë mësimin në gjuhën amtare në Zvicër.*

dëshirës me fanella nga më të ndryshme apo sipas idhujve që kanë në sportin më të popullarizuar në botë – futbollin.

Në fytyrat e prindërve shihej një gëzim i madh, çaste të mrekullueshme, të cilat po i kalonin së bashku me fëmijët e tyre në fushën e sportit, në një natyrë të bukur apo siç thonë mërgimtarët shpesh dhe thjeshtë “si

në Zvicër”. Gjatë gjithë kohës prindërit ishin afër fëmijëve të tyre duke i përkrahur nga loja në lojë deri në përfundimin e turneut.

I gjithë ky organizim, i cili mblodhi fëmijët në fushën e sportit, për disa orë, ishte rezultati i punës së veprimtarëve Vaxhid Sejdiu, Feti Demolli dhe Musli Saiti që mbajtën peshën e këtij aktiviteti.



NXËNËS, MËSUES, KRYETARI I UNIONIT TË KLUBEVE SHQIPTARE NË ZVICËR Z. FETI DEMOLLI, SEKRETARI I PARË I AMBASADËS SHQIPTARE NË BERNË Z. VALON GASHI, KONSULLI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË CYRIH Z. VIGAN BERISHA, TË GJITHË SË BASHKU KËNDUAN, U GËZUAN DHE FESTUAN “SHQIP” NË ZEMËR TË ZVICRËS DUKE DHËNË NJË MESAZH TË FORTË SE BASHKIMI BËN FUQINË.



Nga YLLKA LEZO

# REZIDENCA “FAN NOLI”

E PARA REZIDENCË PËR PËRKTHYES NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHË TË HUAJ

REZIDENCA “FAN NOLI”, E PARA REZIDENCË PËR PËRKTHYES NGA GJUHA SHQIPE NË GJUHË TË HUAJ, NJË NISMË E QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN DHE PJESË E PROJEKTIT “KULTURA LËVIZ EUROPËN”, ZBATUAR NGA INSTITUTI “GËTE”, ORGANIZOI NJË TAKIM PUNE ME RASTIN E DITËS NDËRKOMBËTARE TË PËRKTHIMIT ME TEMË: “POLITIKAT MBËSHTETËSE PËR PËRKTHIMIN LETRAR NË SHQIPËRI”.



## DITA NDËRKOMBËTARE E PËRKTHIMIT

Në Ditën Ndërkombëtare e Përkthimit, e cila sjell në vëmendje rolin e përkthimit, rezidenca “Fan Noli”, e para rezidencë për përkthyes nga gjuha shqipe në gjuhë të huaj, një nismë e Qendrës së Botimeve për Diasporën dhe pjesë e projektit “Kultura lëviz Europën”, zbatuar nga Instituti “Gëte”, organizoi një takim pune me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Përkthimit me temë: “POLITIKAT MBËSHTETËSE PËR PËRKTHIMIN LETRAR NË SHQIPËRI”.

Në këtë takim, u theksua veçanërisht rëndësia e njohjes së të drejtave të përkthyesve dhe mbrojtjes së tyre përmes

zbatimit të Ligjit për të Drejtat e Autorit. Në vijim, diskutimi u përqendrua në domosdoshmërinë për kontrata të drejta dhe pagesa dinjitoze për përkthyesit, si dhe për vendosjen e emrit të tyre në librat e përkthyer. U propozua ngritja e një strategjie për promovimin ndërkombëtar të botimeve shqiptare përmes katalogëve dhe platformave online në gjuhën angleze, financimeve dhe bursave për përkthyesit e gjuhës shqipe. Përkthyesit nënvizuan rolin kyç të përkthimit për kulturën shqiptare dhe nevojën për politika mbështetëse afatgjata në këtë fushë.

## TIRANA GATE 2024 - PËRKTHIMI NË DY KOHË

Përkthyesit e rezidencës “Fan Noli” të Qendrës së Botimeve për Diasporën të ftuar në “Festivalin Ndërkombëtar për të Rinjtë – Tirana Gate 2024”, diskutuan mbi procesin e përkthimit Qendra e Botimeve për Diasporën si pjesë e panelit me temë: “Përkthimi në dy kohë / Atdheu në poezi: Agolli vs Hatibi; Kadare vs Lleshanaku.” Diskutimi u përqendrua mbi sfidat e përkthimit të atdheut në poezitë e Dritëro Agollit dhe Ervin Hatibit, si dhe në poemën “Përse mendohen këto male?” të Ismail Kadaresë dhe “Ujë e karbon” të Luljeta



PËRKTHYESIT E REZIDENCËS “FAN NOLI” TË QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN TË FTUAR NË “FESTIVALIN NDËRKOMBËTAR PËR TË RINJTË – TIRANA GATE 2024”, DISKUTUAN MBI PROCESIN E PËRKTHIMIT QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN SI PJESË E PANELIT ME TEMË: “PËRKTHIMI NË DY KOHË / ATDHEU NË POEZI: AGOLLI VS HATIBI; KADARE VS LLESHANAKU.”



Lleshanakut. U shqyrtua gjithashtu evolucioni i përkthimit, si poezia dhe fjalët “lëvizin” në kohë; atë çka e dallon përkthyesin e sotëm nga ai i traditës, dhe si një përkthyes mund t’i japë veprës dinjitet estetik, duke ruajtur thelbin dhe duke e përshtatur për një audiencë të re. Pjesëmarrësit analizuan thellësisht kuptimin e përkthimit të poezive të Dritëro Agollit dhe Ervin Hatibit, si dhe të veprave madhore të Ismail Kadaresë dhe Luljeta Lleshanakut. Diskutimi u përqendrua në pyetjen se si poezia dhe përkthimi ndryshojnë dhe lëvizin me kohën, duke marrë forma të reja përmes përkthyesit, i cili gjithashtu ndryshon me kalimin e

kohës. Ndër të tjera, në panel u theksua edhe rëndësinë e përkthimit nga gjuha shqipe në gjuhë të huaja, si një akt dinamik që i jep formë të re poezisë shqiptare në arenën ndërkombëtare.

### PËRKTHIMI I NJË POEZIE

Në kuadër të projektit të saj të rezidencës së përkthyesve “Fan Noli”, Qendra e Botimeve për Diasporën, në bashkëpunim me Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, organizoi punëtorinë e përkthimit me temë “Përkthimi i një poezie”.

Në këtë punëtori morën pjesë: studentë që

ndjekin studimet në degët e gjuhës angleze, italiane, gjermane, franceze dhe greke; përkthyesit pjesëmarrës në rezidencën “Fan Noli”: Rigels Halili, Eleana Zhako, Loreta Schillok, Griselda Doka dhe Evelyne Nouygues; drejtoresha e Qendrës së Botimeve për Diasporën, znj. Mimoza Hysa dhe përfaqësues të stafit të Qendrës; redaktorët e përmbledhjes me poezi të Dritëro Agollit dhe njëkohësisht pedagogët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja: Saverina Pasho, Manjola Nasi, Rudina Xhillari, Marsela Lika, Lorena Dedja dhe Mirela Papa. Studentët së bashku me përkthyesit dhe redaktorët punuan konkretisht mbi



përkthimin e një poezie të Dritëro Agollit. Në përfundim të punëtorisë u diskutua rreth procesit të përkthimit, metodologjive të ndjekura për përkthimin, si dhe ndikimin e inteligjencës artificiale në përkthim. Në vijim u shpërndanë certifikata për të gjithë studentët pjesëmarrës.

### SHKËMBIM PËRVOJE ME REDAKTORË

Gjatë një takimi të mbajtur në rezidencën “Fan Noli” përkthyes dhe redaktorë letrarë (pedagogë pranë Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës), të angazhuar në projektin e



### DITA EVROPIANE E GJUHËVE

Në kuadër të Ditës Evropiane të Gjuhëve, Universiteti “Fan S. Noli” në Korçë organizoi një veprimtari me temën “Mbi praktikën e përkthimit letrar shqip-frëngjisht”, duke e pasuruar këtë aktivitet me përvojën e përkthyeses Evelyne Noygues. Aktiviteti ishte një bashkëpunim mes Departamentit të Gjuhëve të Huaja, Aleancës Franceze të Korçës dhe Qendrës së Botimeve për Diasporën. Diskutimet u përqendruan në rëndësinë e profesionalizimit të përkthimit letrar dhe rolin e shoqatave profesionale në trajnimin e përkthyesve përmes platformave online.



përkthimit në pesë gjuhë të poezive të Dritëro Agollit, trajtuan sfidat thelbësore të ruajtjes së autenticitetit në përkthim. Diskutimet u përqendruan në balancimin mes thjeshtësisë dhe kompleksitetit të gjuhës, si dhe në përshtatjen e humorit dhe referencave kulturore shqiptare për një lexues ndërkombëtar. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e bashkëpunimit mes përkthyesit dhe redaktorit për të arritur një përkthim që respekton nuancat gjuhësore dhe artistike të originalit, duke ruajtur ritmin, rimën dhe simbolikën. Ky shkëmbim përvoje u vlerësua si thelbësor për të garantuar cilësinë e përkthimeve dhe për të mbështetur përkthimin e letërsisë shqiptare në nivel ndërkombëtar.

Në punëtorinë e organizuar me nxënësit e seksionit dygjuhësh të shkollës “Raqi Qirinxi” u shqyrtuan përkthimet e realizuara nga ata, si dhe u diskutuan edhe sfidat e kësaj praktike. Në fund, Noygues dhuroi disa libra të përkthyer për bibliotekën e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, duke kontribuar në pasurimin e burimeve letrare aty.





Nga YLLKA LEZO

# SHKOLLAT

## E GJUHËS SHQIPE NË ANGLI

NJË VIT I RI MËSIMOR MES BREZAVE DHE TRADITËS

MISIONI I KËTYRE SHKOLLAVE SHKON PËRTEJ MËSIMIT TË THJESHTË TË GJUHËS; ATO JANË BASTIONET E RUAJTJES SË NJË TRASHËGIMIE KULTURORE QË PËRCILLET NGA PRINDËRIT TE FËMIJËT, DUKE KRIJUAR NË KËTË MËNYRË NJË HAPËSIRË KU FËMIJËT NDIHEN PJESË E DIÇKAJE MË TË MADHE SE VETJA E TYRE.



Viti shkollor 2024–2025, për shkollat e gjuhës shqipe në Angli, ka nisur me entuziazëm dhe risi, si dhe me një angazhim të plotë për ruajtjen e gjuhës, kulturës dhe identitetit kombëtar mes brezave të rinj. Këto institucione arsimore nuk janë thjesht qendra ku mësohet gjuha shqipe; ato përfaqësojnë një lidhje të fuqishme mes brezave të shqiptarëve në diasporë dhe rrënjëve të tyre të origjinës.

Misioni i këtyre shkollave shkon përtej mësimit të thjeshtë të gjuhës; ato janë bastionet e ruajtjes së një trashëgimie kulturore që përcillet nga prindërit te fëmijët, duke krijuar në këtë mënyrë një hapësirë ku fëmijët ndihen pjesë e diçkaje më të madhe se vetja e tyre.





Mësuesit e përkushtuar, shumica e të cilëve janë profesionistë të trajnuar në fushat e arsimit dhe kulturës shqiptare, u japin fëmijëve jo vetëm njohuri, por edhe i frymëzojnë me dashurinë ndaj gjuhës amtare, kulturës dhe historisë shqiptare.

Me një përfshirje gjithnjë në rritje, rreth 300 nxënës ulen këtë vit për herë të parë në bankat e këtyre shkollave në mbarë Anglinë. Klasat janë të projektuara për të mbuluar një spektër të gjerë të temave, përfshirë gjuhën shqipe, historinë kombëtare, gjeografinë, trashëgiminë kulturore dhe, në mënyrë të veçantë, vallet tradicionale shqiptare. Mësimi i gjuhës shqipe jo vetëm që forcon lidhjen

e fëmijëve me origjinën e tyre, por njëkohësisht i ndihmon ata të ndihen pjesë e një komuniteti të gjallë dhe dinamik.

Ky rrjet shkollash luan një rol të rëndësishëm në jetën e familjeve shqiptare në Angli. Përmes këtyre shkollave, prindërit kontribuojnë në ruajtjen e vlerave dhe traditave kombëtare, duke u ofruar fëmijëve të tyre mundësinë për t'u rritur me një ndjenjë të fortë të identitetit kombëtar.

Ndërsa viti shkollor ka nisur, atmosferën e përshkon një frymë entuziazmi dhe përkushtimi, ku çdo mësues, nxënës dhe prind bashkohet në këtë mision të përbashkët për të mbajtur gjallë gjuhën dhe kulturën tonë.



## DISA NGA SHKOLLAT KU MËSOHET GJUHA SHQIPE

### Shkolla “Nënë Tereza” (Romford)

**Data e hapjes:** 7 shtator 2024

**Adresa:** Saint Edward the Confessor, 5 Park End Road, RM1 4AT

**Ora:** 9:30 – 12:30

**Kontakti:** 02089453212

### Shkolla “Nënë Tereza” (Bournemouth)

**Data e hapjes:** 7 shtator 2024

**Adresa:** Anglo-Continental 29-35 Wimborne Road, Bournemouth, BH2 6NA

**Ora:** 10:30 – 13:30

**Kontakti:** info@nenetereza.co.uk

### Shkolla shqipe e Shoqatës “Arbëria” (Wood Green, Londër)

**Data e hapjes:** 23 shtator 2024

**Adresa:** King Edward VI Lordswood School for Girls, Harborne, B17 8QB

**Ora:** 10:00 – 12:00

**Kontakti:** 07852212249

### Shkolla shqipe “Kosova” (Londër)

**Data e hapjes:** 8 shtator 2024

**Adresa:** Londër, vendi TBC

**Ora:** 11:00 – 13:00

**Programi për fëmijët nën 5 vjeç:** “Eja të luajmë dhe të flasim shqip”

**Kontakti:** 07940471761

### Shkolla shqipe “Pjetër Budi” (Liverpool)

**Data e hapjes:** 21 shtator 2024

**Ora:** 13:00 – 15:00

**Adresa:** Speke Training & Education Centre (STEC), Unit House, Speke Boulevard, Liverpool, L24 9HZ

**Kontakti:** 07913949540 | pjeter\_budi@yahoo.com

### Shkolla shqipe “Bright Eagles” (Birmingham)

**Data e hapjes:** 21 shtator 2024

**Ora:** 10:00 – 12:00

**Adresa:** King Edward VI Lordswood School for Girls, Harborne, B17 8QB

**Kontakti:** 07852212249 | info@brighteagles.co.uk

### Shkolla shqipe “Iliria” (Barnet, Londër)

**Data e hapjes:** 14 shtator 2024

**Ora:** 10:00 – 13:30

**Adresa:** 3 Stapylton Rd, Barnet EN5 4QT, Chipping Barnet

**Kontakti:** 07555126064 | email: djana.kociaj67@gmail.com





Nga YLLKA LEZO

# IRIS HALILI

KTHIM TEK RRËNJËT ME KLUBIN “FLAS SHQIP” NË FLORIDA

” NË NJË KOHË KUR SFIDAT E RUAJTJES SË IDENTITETIT KULTUROR DHE GJUHËSOR PO BËHEN GJITHNJË E MË TË MËDHA PËR SHQIPTARËT NË DIASPORË, INICIATIVAT SI KLUBI “FLAS SHQIP” NË FLORIDA JANË DRITË SHPRESE PËR BREZAT E RINJ. ”

*Iris Halili, me një përkushtim të veçantë për gjuhën dhe trashëgiminë shqiptare, krijoi klubin “Flas Shqip”, i cili ka për qëllim të mbajë të gjallë gjuhën shqipe mes fëmijëve të diasporës shqiptare në jug të Floridës.*

*Ideja e krijimit të këtij klubi lindi nga dashuria e thellë për gjuhën shqipe dhe shqetësimi që kjo pasuri e kombit po venitet ndër brezat, të cilët rriten në një ambient ku dominon anglishtja dhe ku shqipja rrezikon të mbetet vetëm një kujtim i largët.*

*Ajo, me një vullnet të fortë, themeloi klubin me qëllimin që t’u ofrojë fëmijëve shqiptarë në Florida një hapësirë ku mund të mësojnë dhe të flasin gjuhën e tyre amtare pa ndonjë barrë apo presion. Me një vizion të qartë, ajo kërkon jo thjesht mësim të gjuhës, por krijimin e një mjedisi të këndshëm ku fëmijët të përqafojnë kulturën shqiptare me gëzim. Klubi nuk është një shkollë tipike: nuk ka detyra shtëpie, nota apo provime; përkundrazi, ka një qasje më të lirë*

*dhe argëtuese, duke synuar që fëmijët të ndihen të motivuar për të folur shqip përmes lojërave dhe aktiviteteve sociale.*

*Përtej aspektit edukativ, klubi “Flas Shqip” ka marrë një rol kyç edhe në forcimin e lidhjeve mes komunitetit shqiptar në jug të Floridës, një komunitet i shpërndarë dhe i brishtë, që nuk kishte një pikë referimi deri më tani. Brenda tre muajve nga krijimi i tij, klubi ka bashkuar familje shqiptare nga të gjitha trojet, duke u kthyer në një urë që lidh brezat dhe ruan ndjenjën e përkatësisë.*

*Në këtë intervistë, Iris Halili rrëfen sfidat dhe sukseset e këtij projekti, nga vështirësitë për të gjetur mësues të kualifikuar deri te përpjekjet për të përfshirë sa më shumë fëmijë në klasat e klubit. Me përkushtim të palëkundur dhe mbështetjen e komunitetit, ajo synon që ky klub të shërbejë si një model për ruajtjen e gjuhës shqipe në diasporë, duke mbajtur të gjallë një nga pasuritë më të çmuara të kombit tonë.*

**Znj. Halili, si lindi ideja për krijimin e klubit “Flas Shqip” dhe cili ishte motivimi kryesor pas kësaj iniciative?**

Ideja bluante në mendjen time prej vitesh. Motivi që më shtyu mban së bashku dashurinë dhe dhimbjen. Dashurinë për gjuhën shqipe, që lidhet padyshim me dashurinë për Atdheun, dhe dhimbjen që kjo gjuhë, nëse nuk do mësohet dhe nuk do të flitet nga shqiptarët anembanë botës, pak nga pak do të fillojë të tkurret dhe të lokalizohet vetëm në tokat tona në Ballkan. Historia na ka mësuar se shqiptarët e mbajtën të gjallë gjuhën shqipe për të mbijetuar si komb. Kjo ishte revolta e fshehur, por e fortë, për të mos iu nënshtruar armiqve. Shqiptarët ndërruan fetë por jo gjuhën, duke u kthyer kështu në një popull që mbijetoi



është simboli më i fuqishëm që kemi ne si komb, vjetërsia e saj, trashëgimia e saj, qëndresa e saj, por mbi të gjitha veçantia e saj si unike mes të gjitha gjuhëve indoevropiane. Gjuha jonë, sipas meje, mbetet krenaria më e madhe kombëtare e të gjitha kohëve. Për këtë arsye, gjuha shqipe jo vetëm që nuk duhet humbur, por me patjetër duhet punuar dhe duhet gjetur mundësia që t’u mësohet të gjithë fëmijëve shqiptarë që lindin dhe rriten nëpër botë. Gjithmonë më mundon kur shikoj që komunitetet më të fuqishme në SHBA forcën e kanë tek ruajtja e gjuhës dhe zakoneve në komunitetin e tyre. Pra, që t’i përgjigjem më drejtpërdrejt pyetjes suaj: klubi “Flas Shqip” u hap që t’i thotë stop humbjes së gjuhës shqipe tek të gjithë emigrantët shqiptarë në shtetin e Floridës së Jugut.



mbi të gjitha falë kësaj gjuhe. Tashmë janë kohë të tjera dhe jo vetëm shqipja, por edhe gjuhët dikur më të përhapura apo elitare e kanë humbur vlerën përpara anglishtes, që është gjuha parësore në botë e komunikimit politik, kulturor, teknologjik dhe sigurisht shumë shpejt robotik, kështu që nuk do të jetë e largët dita kur shqipja do të mbetet gjuha e pakicave që jetojnë brenda kufijve shqiptarë.

Pyetja është: A nuk ka qenë gjithmonë kështu? A nuk është folur gjuha shqipe vetëm brenda kufijve të tokave të banuara nga shqiptarë? Po, kështu ka qenë dhe kështu do të jetë, por motivi që e ka mbajtur gjuhën gjallë nuk është më i njëjtë.

Tashmë shqiptarët nuk e kuptojnë apo nuk e ndiejnë gjuhën si mekanizmin e vetëm të mbijetesës si komb dhe unë them se edhe kanë të drejtë, por edhe nuk kanë të drejtë. Kanë të drejtë pasi për të mbijetuar sot si komb, gjuha nuk është mjeti i vetëm, për shkak se mbijetesa si individ, familje apo komunitet shqiptar, në tokat tona apo jo, nuk bazohet vetëm nga mbrojtja e gjuhës. Nga ana tjetër, e tashmja kërkon gjithmonë të jetë e sigurt mbi baza të forta që vijnë nga e shkuara, por edhe që e sigurojnë të ardhmen. Kjo e bën gjuhën të mbetet padyshim faktori më i rëndësishëm që na ka mbajtur bashkë, na ka identifikuar, na ka shërbyer si mburojë;

***Dhe cilat janë disa nga sfidat me të cilat jeni hasur në punën tuaj me klubin “Flas Shqip”?***

Kur e mora këtë iniciativë, e dija që do të hasja disa vështirësi që lidhen me shumë faktorë: së pari, komuniteti shqiptar këtu nuk është i përqendruar në një, dy apo tre qytete, por i shtrirë në më shumë se 100 km. Kështu, për të përmbushur përfshirjen e sa më shumë fëmijëve, synuam që, brenda mundësive, të hapim sa më shumë klasa. D.m.th. jemi të shtrirë nga jugu në veri duke mbuluar perimetrin e të gjithë Floridës së Jugut. Qëllimi final është të kemi klasa në çdo qytet, pasi kjo do ta lehtësonte shumë transportin e prindërve që i sjellin fëmijët çdo të shtunë apo të diel në klasa; por, çka është më e rëndësishmja, do të rrisë shumë numrin e nxënësve nëpër klasa, pasi shumë prindër nuk kanë mundësi të sjellin



fëmijët në një qytet kur janë ndërkohë me banim në një qytet tjetër, ku distanca sipas standardeve amerikane mund të mos jetë shumë e largët, le të themi 20 km, por është trafiku që e rrit shumë atë.

Vështirësia tjetër është se prindërit këtu punojnë me orare të zgjatura, madje shpesh edhe në fundjavë; kjo më bën të besoj se kemi aktualisht të paktën 1/5 e atyre nxënësve që do të ishin regjistruar me vullnet të mirë të prindërve, por me pamundësinë e tyre për të lënë punën me të cilën mbajnë familjen.

Vështirësia e tretë është se disa prindër kanë vetëm një ditë pushimi në javë ose edhe ato ditë që kanë, nuk mund t'i sjellin fëmijët rregullisht. Nga ana tjetër, klubi ka një rregullore që nuk lejon më shumë se 4 mungesa

në semestër, dhe kjo bëhet që të respektohet progresi me fëmijët e tjerë. Në këto kushte, shumë prindër hezitues gjejnë rrugën e heqjes dorë krejtësisht nga klasat.

Një vështirësi tjetër është gjetja e mësueseve profesionale që sjellin përvojën dhe edukimin që klubi ka si standard. Megjithatë, mendoj se për kushtet që jemi deri më tani, klubi ka ofruar lehtësi që janë gati unikale dhe kjo, po të krahasohet me të ngjashmet e saj nëpër botë, mësimi bëhet krejt falas, pra, prindi nuk ka asnjë detyrim për të paguar. Po kështu, klasat mund të ndiqen edhe online në rast se fëmija nuk ka mundësi të vijë rregullisht, por kjo është e lejueshme jo më shumë se 2 herë përgjatë semestrit. Fëmijët nuk sforcohen me didaktikë të vështirë dhe, meqenëse janë

fillestarë, ata nuk kanë filluar me “Abetare”, por me një libër të thjeshtë nëpërmjet të cilit po mësojnë fillesat e komunikimit, si: prezantimi i vetes, familjes, ngjyrat, flamuri kombëtar etj. Hap pas hapi po ndërtoj një didaktikë krejt më vete për t’u mësuar fëmijëve të diasporës gjuhën e nënës apo të babait. Mendoj se deri më tani është bërë një gabim në shumë shkolla të gjuhës shqipe nëpër botë dhe që ka kaluar pa u kuptuar – **gjuha shqipe për fëmijët e emigracionit është gjuhë e dytë dhe si e tillë duhet mësuar me rregullat që pranon një gjuhë e dytë, po kështu duhen mësuar edhe traditat dhe kultura shqiptare. Më e rëndësishmja është që fillestarët, fëmijë apo jo, nuk mund ta nisnin mësimin e gjuhës shqipe me librin e abetares**, pasi kështu ata bëhen konfuzë me shkronjat e alfabetit shqip dhe, le të themi, atij anglez, që në shqiptim janë krejt të ndryshme. Të mos harrojmë, ne në Shqipëri e kemi nisur abetaren në moshën kur e flisnim shqipen rrjedhshëm; për fëmijët e emigracionit, sigurisht, nuk mund të presim kaq gjatë, por unë mendoj se gjuha fillon, së pari, me të kuptuarit, më pas me të folurit bazë dhe më pas vazhdon me të shkruarit, d.m.th. hyn në proces libri i abetares. Nëse këta fëmijë nuk e kanë veshin të mësuar qoftë me këngë dhe valle shqiptare, do ta kenë shumë të vështirë të kalojnë drejtpërdrejt në abetare. Në krye të të gjitha vështirësive, dhe që përbën edhe dhimbjen më të madhe për ne, është që fëmijët shqiptarë në SHBA, d.m.th. me prindër shqiptarë të emigracionit të parë apo të dytë, flasin pak ose aspak shqip. Me

një statistikë që nuk besoj se gabon, mund të them se e shumta vetëm 7 për qind e fëmijëve shqiptarë në SHBA flasin shqip. Pothuaj të gjithë fëmijët e miqve tanë, d.m.th. miq që kanë fëmijë nga moshë 15–25 vjeç, nuk dinë fare shqip ose dinë le të themi jo më shumë se 100 fjalë. Për mua, nga këto 100 fjalë sot, nesër janë 5 fjalë të trashëguara për fëmijët e tyre, dhe kjo është varrosja e gjuhës shqipe në emigracion, por edhe e lidhjes shpirtërore me vendin e të parëve. Se si ka mundësi që prindërit shqiptarë nuk u flasin shqip fëmijëve në një vend shumëkulturor si SHBA-ja, unë këtë nuk di si ta shpjegoj apo nuk po dua ta shpjegoj në këtë intervistë. Gjithashtu, vizioni im akademik për klubin “Flas Shqip” është të mos i jap trajtat e një shkolle, por të një mjedisi ku fëmija apo edhe i rrituri vjen të kalojë dy orë të këndshme, por me misionin për të folur shqip me kënaqësi dhe jo me detyrim. Klubi nuk ka as detyra shtëpie, as teste, as nota, vetëm nëse ato janë nota maksimale. Unë gjithmonë kam pasur parimin që çdo dije e sforcuar krijon efektin e kundërt. Ndaj dëshiroj që klasat e klubit të funksionojnë jo me imponim, por me argëtim. Për këtë arsye e kam quajtur klub dhe jo shkollë klasike.

***Ju ofroni mësimin e gjuhës shqipe falas për të gjithë fëmijët. Si arrini ta realizoni këtë në një mënyrë që të përfshijë sa më shumë fëmijë dhe familje shqiptare?***

Unë vetë kam qenë studente me bursë në Romë, Itali, si studente e PHF-së apo siç quhet ndryshe “Followers of Paul Harris”,

që është Presidenti dhe themeluesi i Rotary Club, që është dhe mbetet organizata më e madhe vullnetare në botë. I kam ndjekur aktivitetet e Rotary-t që kur isha vajzë fare e re në Shqipëri dhe më bënte përshtypje fryma e vullnetarizmit, bamirësisë dhe shërbimit. Paul Harris ka një shprehje shumë të bukur për vullnetarizmin, të cilën unë mundohem ta aplikoj sadopak denjësisht tek klubi “Flas Shqip”, “Vatra Maimi” apo në çdo organizatë ku unë punoj vullnetarisht: “*Service above Self*”, që do të thotë “Shërbimi përmbi veten”. Ati i klubit Rotarian e krijoi këtë organizatë në vitin 1905 dhe në fakt lidhshipi i tij ka parimin e lidhshipit shërbëtor që vjen si teori e tillë në letra në vitin 1971 nga Robert Greenfield. D.m.th. gati 6 dekada më parë se teoria e Greenfield, Paul Harris kishte vënë në praktikë porosinë e Jezusit që, për të qenë lider, më parë duhet të shërbesh. Ky është edhe parimi im. Lideri i vërtetë flet nëpërmjet veprave të mira që shkojnë përtej çdo interesi personal. Unë e dija që në fillim se ky mision është i shenjtë, ky mision i ngjan atij të nënës që na e mëson gjuhën falas, dhe brenda meje **nuk mund të pranoja apo të pranoj t’u mësoj fëmijëve të gjakut tim kundrejt një pagese gjuhën tonë të shtrenjtë, për të cilën heronjtë tanë kanë dhënë jetën. Ata dhanë jetën, ne nuk u dashka të japim disa orë vullnetare në javë!!!** Mund të them se ky klub ka qenë i bekuar që ditën e parë që u krijua në zyrën e një prindi dhe vazhdoi të ishte i tillë kur prindër dhe anëtarë vullnetarë iu shtuan ditë pas dite. Klubi ka qenë i bekuar

me mësues vullnetarë që janë ofruar, pasi për momentin ne nuk kemi mundësi pagese për ta, por vullnetarizmi dhe dashuria e tyre për mësimdhënie është e jashtëzakonshme. Synimi është që në të ardhmen mësueset apo të gjithë vullnetarët në klub të shpërblehen me bonuse dhe pagesa mirënjohjeje nga më vlerësueset, dhe secili sipas kontributit që ofron. Ashtu sikurse na mësonte Paul Harris “*One Profits Most Who Serves Best*” [“Përfitimi më i madh për atë që shërben më mirë”]. E gjitha kjo është një eksperiencë e re për ne dhe sigurisht ndryshimet do të jenë gjithmonë pjesë e jona, por vetëm diçka do të jetë e gdhendur në mur apo sipas kohëve tona hyrë për të mos u shuar në iCloud: “Mësimi i shqipes në klubin ‘Flas Shqip’ do të bëhet gjithmonë falas dhe i gjithë aktiviteti do të respektojë ligjet që drejtojnë organizatat jofitimprurëse në SHBA, siç edhe është regjistruar kompania ku bën pjesë klubi ‘Flas Shqip’ pikërisht në shtetin e Floridës”. Kuptohet, kjo rrugë do një zemër të madhe atdhetare dhe unë mendoj se engjëjt e klubit “Flas Shqip” gjithmonë do ta kenë shansin të gjejnë tek klubi ynë mësimin e gjuhës dhe jo vetëm, pasi ne synojmë t’u mësojmë edhe traditat shqiptare, si dhe zakonet tona që na veçojnë si bij të shqipes, pikërisht ato zakone të mira që i trashëgojmë nga të parët tanë dhe që i shërbejnë çdo shqiptari të mirë të adaptohet me kulturën amerikane. Nga ana tjetër, do të shtoja këtu se kam mbetur vërtet e impresionuar nga website-i i Qendrës së Botimeve për Diasporën, ku

” GJUHA SHQIPE PËR FËMIJËT E EMIGRACIONIT ËSHTË GJUHË E DYTË DHE SI E TILLË DUHET MËSUAR ME RREGULLAT QË PRANON NJË GJUHË E DYTË; PO KËSHTU DUHEN MËSUAR EDHE TRADITAT DHE KULTURA SHQIPTARE. MË E RËNDËSISHMJA ËSHTË QË FILLESTARËT, FËMIJË APO JO, NUK MUND TË NISIN MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE ME LIBRIN E ABETARES...  
... NE NË SHQIPËRI E KEMI NISUR ABETAREN NË MOSHËN KUR E FLISNIM SHQIPEN RRJEDHSHËM; PËR FËMIJËT E EMIGRACIONIT, SIGURISHT, NUK MUND TË PRESIM KAQ GJATË, POR UNË MENDOJ SE GJUHA FILLON SË PARI ME TË KUPTUARIT, MË PAS ME TË FOLURIT BAZË DHE MË PAS VAZHDON ME TË SHKRUARIT.”



fëmijët emigrantë mund të kenë në dorë libra dhe literaturë nga më të arrirat. Unë mendoj se kjo Qendër duhet të fillojë t’i shesë librat në Amazon, qoftë edhe për një dollar; e them këtë pasi shumë prindër apo edhe individë të apasionuar pas gjuhës shqipe mund të mos e dinë se ekziston një Qendër shumë profesionale me literaturë të gjuhës shqipe. Kjo do të heqë edhe spekulimet e disa botimeve që e kanë gjuhën shqipe në to, të më falni për termat, të bastarduar. M’u desh të blija një libër me rrëfenja shqiptare nga një autor i huaj, libër që më shumë e bleva të di si i kishte mbledhur këto rrëfenja. Ishte e pabesueshme kur pashë që, duke filluar nga emrat, ai libër nuk kishte asnjë lidhje me kulturën tonë, dhe në atë botim asgjë nuk ishte shqiptare. Nuk

ngurova t’i bëj një koment negativ këtij libri. Por, nga ana tjetër, siç thashë, Amazon është dritarja e parë nga ku lexuesit e gjithë botës kërkojnë të blejnë një libër, ndaj mendoj se Qendra e Botimeve për Diasporën duhet të bashkëpunojë në këtë drejtim. Gjithashtu, mendoj se librat për fëmijët e emigrantëve duhet të jenë jo *one size fits all*, siç thonë amerikanët, domethënë një format libri për çdo emigrant paçka se ku jeton. Unë mendoj se ndryshe duhet të jetë libri bazë i gjuhës dhe kulturës shqipe për fëmijët me prindër që flasin shqip dhe ndryshe për fëmijë me prindër që nuk flasin shqip, dhe ju siguroj se unë, po, kam disa prindër të tillë; gjithashtu ndryshe duhet të jetë një libër për fëmijën e emigrantit në Greqi dhe ndryshe për fëmijën

në Kaliforni. Bashkëpunimi me shkollat apo mësuesit që japin gjuhën në botë duhet të vazhdojë dhe të thellohet në detaje edhe më shumë.

Për sa u përket nxënësve të klubit “Flas Shqip”, fëmijët tanë nuk janë ende në gjendje të mësojnë me literaturën e botimeve të diasporës shqiptare, por besoj se vitin tjetër ata do të fillojnë ta shfrytëzojnë atë. Kjo ndihmë është e jashtëzakonshme dhe duhet vlerësuar si një hap shumë i mirë. Vullnetarizmi i KLUBIT FLAS SHQIP dhe literatura falas e shtetit shqiptar përbëjnë për mendimin tim modelin e përkryer të shërbimit. Këtu dua të shtoj edhe diçka tjetër që besoj është edhe si apel për qeverinë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. Ruajtja e gjuhës shqipe në emigracion duhet të konsiderohet mision kombëtar dhe detyrë shtëpie për çdo qeveri shqiptare apo organizëm serioz shqiptar kudo ku vepron. Shërbimi ndaj fëmijëve të vegjël sot për të mësuar shqip është forcimi i një komuniteti të përbashkët që më shumë se çdo gjë e lidh gjuha. **Fëmijët e sotëm janë lobistët e ardhshëm, janë ata që u duhet gjuha për të mos ndërprerë lidhjet me atdheun e tyre.**

Të gjitha komunitetet që drejtojnë sot direkt apo indirekt botën, fuqinë e kanë arritur falë bashkimit që ka ardhur nga edukimi dhe shoqërimi i fëmijëve të tyre që në vogëli. Qeveritë e vendeve tona duhet të mendojnë për të shtrirë ndihmën edhe në hapjen dhe sponsorizimin e qendrave shqipfolëse në çdo cep ku ka shqiptarë. E them këtë se nëse ky aksion, e përsëris kombëtar, bëhet i organizuar

dhe me traditë të shënuar në kushtetutë për të ndihmuar gjuhën dhe kulturën shqipe në botë, e ardhmja e gjuhës sonë dhe komuniteteve tona shqiptare do të jetë në rrugë shumë të mbarë.

***A keni bashkëpunime me organizata të tjera shqiptare ose të huaja për të mbështetur aktivitetet e klubit? Besoj roli i organizatës “Vatra Miami” është i madh në punën tuaj.***

Klubi, në maj të këtij viti, hodhi mesazhin e tij të parë në festën e Nënës, kur “Vatra Miami”, degë të cilën unë drejtoj, festoi me motivacionin “Në ditën e nënës me gjuhën e nënës” dhe ku fëmijët, së bashku me këngëtareshen e ftuar Artiola Toska, kënduan këngën që tashmë është himni i klubit: “Fol shqip se je shqiptar”. Në muajin qershor filluan regjistrimet, u bënë disa klase vere dhe ka vetëm një muaj që, siç thashë, kanë filluar klasat akademike. Vatra është indirekt inkurajuesja e këtij projekti të madh për arsyen se themeluesit e saj, Noli dhe Konica, kur krijuan Federatën PanShqiptare “Vatra”, i vunë asaj një gur themeli që mbetet amanet për çdo vatan – ruajtjen e gjuhës dhe traditës shqiptare. Ndaj unë them se çdo vatan duhet ta këtë ruajtjen e gjuhës shqipe si mision përmbi çdo mision tjetër. Ndërkohë, nga pozicioni i një vatraneje, unë mendova se e vetmja gjë që i duhet organizatës “Vatra Miami” është të krijojë një komunitet të bashkuar, që Florida e Jugut nuk e ka pasur kurrë, për shumë arsye, si: emigracioni këtu është i ri, janë shumë migrantë nga zona të tjera të SHBA-së, distancat janë të mëdha dhe

bota që na rrethon ka një mot pothuaj verë dhe plazh përgjatë gjithë vitit, sikurse ka edhe mjedise kulturore që zona e Majamit i ka të njohura tashmë. Të gjitha këto krijojnë shumë mundësi tërheqjeje, përtej asaj për të qenë të grumbulluar bashkë, siç është në shumë zona të tjera ku jetojnë shqiptarët. Kuptohet, t’i bësh shqiptarët bashkë nuk është mision i lehtë, por gjithsesi jo i pamundur. Siç e theksova më sipër, ka ardhur koha që qeveritë shqiptare të kenë programe të posaçme dhe për këtë edhe unë e kam një propozim që dua ta paraqes së shpejti. Jo se emigracioni nuk arrin të bëhet bashkë dhe do tutorizimin e qeverive nga vijnë, por sepse qeveritë duhet të investojnë që ta mbajnë komunitetin e tyre të lidhur dhe të denjë për t’i shërbyer vendit amë në çdo kohë. Kjo është në interes të çështjes kombëtare dhe vizionit të së ardhmes. Ndërkohë klubi “Flas Shqip” po krijon lidhje edhe me shumë organizata simotra, donatorë etj., por le të mos harrojmë këtu se klubi ka vetëm pesë muaj nga dita kur është krijuar.

***Dhe, duke qenë se keni nisur edhe aktivitetin në bashkëpunim me “Vatra Miami”, si ka ndikuar ky bashkëpunim në realizimin e aktiviteteve tuaja?***

Unë nuk dua ta ndaj “Vatrën” nga klubi “Flas Shqip”, pasi, edhe po të dua unë, ata nuk ndahen për të gjitha arsyet që rendita më sipër, ndaj çdo aktivitet i ka takuar të dyve bashkë. Klubi mbetet më shumë i fokusuar tek fëmijët dhe te mësimi i gjuhës dhe kulturës shqipe, ndërsa “Vatra” ka dhe mund të marrë edhe

angazhime të tjera që bazohen në respektim të kanunores bazë të saj tashmë 112-vjeçare. “Vatra” dhe klubi sot për sot veprojnë si një trup i vetëm dhe mbështeten në të njëjtin mision. “Vatra” i jep amanetin e Nolit dhe Konicës klubit, por klubi po i jep hov “Vatrës” për të dalë nga monotonia e të njëjtave aktivitete që shpesh duket sikur përsëritin vetveten.

***Deri tani, sa fëmijë janë regjistruar në klub për të ndjekur mësimet e shqipes dhe si është strukturuar ky proces mësimor?***

Deri tani kemi 70 fëmijë të regjistruar, por rreth 60 nxënës vijnë rregullisht. Klubi ka një kod etike që i prezanton prindërit me misionin dhe vizionin e tij, si dhe vendos themelet se në ç’mënyrë do të funksionojnë klasat dhe aktivitetet. Po ashtu ka një website, modest për momentin ([www.klubiflashshqip.com](http://www.klubiflashshqip.com)), faqe në Facebook dhe ndërkohë poston në faqen zyrtare të Instagram-it dhe Facebook-ut të Vatrës. Mësimi ka një metodikë që unë po e ndërtoj vetë sipas parimit: kurrikula duhet të jetë e njëjtë në çdo klasë, por forma si e shpjegon mësuesja mund dhe duhet të jetë personale, që t’i hapë kështu rrugë krijimtarisë së vetë mësuesit. Fillimet e klasave kanë pasur një rrjedhë logjike që shkon me natyrën si shkojnë gjërat në jetë, pra, në fillim jam unë, më pas vjen prezantimi im, më pas vjen familja, më pas vijnë ngjyrat me të cilat unë dalloj botën përreth e kështu me radhë. Por kryefjala është “unë”, sepse fëmija i vogël ka shumë nevojë për vetëbesim. Ndaj kur u bëja



pyetjen në anglisht: “Kush është gjëja më e rëndësishme për ju?”, në fillim habiteshin kur u thosha vetja juaj, por tani e thonë madje edhe me zë të lartë.

Klubi ndërkohë ka katër klasa të rregullta: në Miami, në Hollywood, në Boca Raton dhe në West Palm Beach. Shumë shpejt do të hapim klasat e Fort Lauderdale dhe Lake Worth.

***Çfarë roli luan klubi “Flas Shqip” në forcimin e lidhjeve mes komunitetit shqiptar dhe komunitetit më të gjerë të Floridës së Jugut?***

Besoje se është bërë një pikë shumë kyçe e lidhjes së komunitetit dhe nëse do të arrijmë të kemi fondet e nevojshme, do të jemi shtylla kryesore e këtij komuniteti të brishtë dhe pa traditë mes vedit. Jam krenare të them se klubi ka lidhur shqiptarët e të gjitha trojeve, që nga Kaçaniku deri në Fier, nga Tirana deri në Gostivar, nga Ulqini deri në Korçë. Kjo mbetet krenaria më e madhe për momentin, pasi kurrë më parë në Floridën e Jugut nuk ka pasur një grupim kaq misionar dhe atdhetar. Ajo që dua ta theksoj dhe që ju mund ta vërtetoni fare thjesht është se klubi nuk ka protagonizëm. Unë vërtet e kam themeluar dhe e drejtoj atë, por aktivitetet dalin në emër të klubit “Flas Shqip” dhe jo timin, vendimet merren me konsultën e bordeve përkatëse (Bordi i Edukimit, Bordi i Financave dhe Bordi i Aktiviteteve). Klubi i ka të gjitha financat transparente dhe mbi të gjitha komunikimin gjithmonë të tillë. Gjej rastin të falënderoj këtu prindërit e parë që më besuan pa mëdyshje në këtë mision:

vëllezërit Dekaj, L. Smailaj, U. Selimaj, A. Hoti, M. Beca, A. Dedaj, si dhe mësuesen e parë që shprehu gatishmërinë për të punuar si vullnetare, zonzjën Liliana Rrumbullaku. Ndërkohë falënderoj nga zemra të gjitha familjet shqiptare që kanë regjistruar fëmijët në klubin “Flas Shqip” dhe u përsëris se pa ta ky mision do të ishte një ëndërr në sirtar.

***Si e shikoni të ardhmen e klubit “Flas Shqip”? Çfarë planesh keni për zgjerimin ose përmirësimin e shërbimeve që ofroni?***

E shoh si një klub që nuk do të shuhet kurrë, herë me rritje dhe herë me pak zbritje, por asnjëherë në mbyllje. E shoh si vendin ku po formohen lobingjet e para të vërteta të shqiptarëve sot të vegjël në moshë, por nesër faktor vendimtar në ruajtje të historisë dhe tokave të atdheut të të parëve të tyre. Klubin e shoh më shumë si frymë sesa si korporatë, e vlerësoj më shumë si komunitet sesa si krenari personale dhe mbi të gjitha e shoh si çadrën humanitare ku çdo shqiptar i vërtetë duhet të vijë vullnetar për t’u folur fëmijëve shqip, pasi nuk ka vullnetarizëm më të shenjtë se t’i shërbesh kombit tënd apo kombit të të parëve të tu. Shpërblimin në këtë rast ta jep historia. Klubin e shoh si modelin që do të bëjë shumë familje shqiptare këtu të flasin të paktën 10 fjalë shqip çdo javë, dhe kjo si fillim është fitore, se 10 fjalë unë, 10 fjalë ti dhe me këtë ritëm gjuha jonë jeton. Ky sot është një mision i shenjtë dhe unë ftoj të gjithë shqiptarët e vërtetë t’i bashkohen atij.

” KLUBIN “FLAS SHQIP” E SHOH SI NJË MODEL QË DO TË NDIQET NË TË GJITHA KOMUNITETET SHQIPTARE NË SHBA DHE NË BOTË, KUDO KU KA FËMIJË SHQIPTARË T’U MËSOJMË SHQIPEN FALAS DHE JO MË ME METODA STRIKTE DIDAKTIKE, POR ME METODA TËRHEQËSE DHE EDUKUESE TË SHPIRTIT, NË MËNYRË QË T’UA VENDOSIM FËMIJËVE SHQIPEN SË PARI NË ZEMËR DHE MË PAS NË MENDJE. ”



***Ju përmendni që vizioni juaj është që asnjë fëmijë shqiptar në Floridën e Jugut të mos mbetet pa mësuar gjuhën shqipe. Si siguroheni që ky synim të arrihet në praktikë?***

Kemi filluar dhe do ta mbajmë gjithmonë këtë premtim – mësime falas. Në më pak se 3 muaj jemi shtrirë në 120 km. Sigurisht, nuk është punë e lehtë, se, së pari, duhet të bindësh prindërit për këtë mision, dhe për këtë duhet

të kesh sukses me nxënësit dhe ekipin e sapoformuar. Suksesi më pas të shton radhët e nxënësve. Dija, ndershmëria, korrektësia dhe serioziteti i punës sonë do të jetë baza e shtimit të klasave. Plus, klubi mendon të zgjerohet me studentët, gratë dhe gjithashtu me biznesin sipas parimit të “Vatra Miami”: “Shqiptarët që i bëjnë biznes shqiptarëve”. Unë gjithmonë e kam thënë, jemi më të fortë po të jemi bashkë. Por fjala “bashkë” është

” SHQIPTARËT KANË GJUHËN E NËNËS PËR TË FOLUR SHQIP, ZEMRËN E BABËS PËR TË LUFTUAR SI BURRAT DHE JETËN E TYRE, ATË QË I DUHET PËR ATDHEUN. ”

shumë e vështirë mes nesh, pasi gjithmonë sikur gjendet diçka të na ndajë, sidomos nëse shohim suksesin e tjetrit nuk e kapërdijmë apo përgëzojmë lehtësisht. Unë kam besim te këta fëmijë, pasi ata po rriten në një mjedis tjetër, shpesh të egër, shumë individualist (flas për kulturën amerikane), por që në fund të ditës ka diçka pozitive që ne shqiptarët nuk e fituam kurrë: Vlera e tjetrit nuk shihet sikur ta ka hequr ty vlerën, por si mundësi për të të dhënë ty një model, që mund të të motivojë për vepra edhe më të arrira.

***Dhe si ka qenë përgjigjja e komunitetit shqiptar ndaj aktiviteteve të klubit? A keni parë rritje të interesit për ruajtjen e gjuhës dhe traditave shqiptare?***

Po, shumë! Dhe të mendosh që nuk është se kemi pasur ndonjë reklamim apo financim nga influencuesit e kohës postmoderne, ku fatkeqësisht matet sukcesi në ditët e sotme. Çdo gjë ka qenë fare natyrale, spontane dhe e thjeshtë, por ja që kur gjërat bëhen me zemër të madhe, është forca e mirësisë që projekton çdo gjë. Pastaj, fëmijët e kanë mirësinë dhe bekimin me vete. Klubi vetëm se rrezaton dritën e tyre. Këtu dua të falënderoj edhe donatorët e klubit që në më të shumtën janë prindër apo familjarë të fëmijëve të regjistruar në klub, si dhe donatorin kryesor, i cili është një histori e vërtetë sukcesi në SHBA – Florida, por, si të gjithë donatorët fisnikë, nuk dëshiron të mburret për donacionin e tij, ndaj dhe unë po ia respektoj dëshirën duke mos ia përmendur emrin këtu.

***Cila është rëndësia e ruajtjes së gjuhës shqipe për fëmijët që jetojnë në emigracion dhe si mendoni që kjo gjuhë do të ndikojë në identitetin e tyre?***

Nëse duam që të mbijetojë identiteti ynë, ai që na bën shqiptarë, duhet të ruajmë gjuhën. Sipas studiuesve më të mëdhenj të shkollave të gjuhësisë, gjuha që flet është faktori kryesor i kulturës që gjithkush prezanton apo trashëgon. Çështja është se disa nga ne nuk duan të mbeten shqiptarë, por as klubi “Flas Shqip” dhe besoj askush nuk të detyron me zor të ndihesh artificialisht i tillë. Misioni ynë është dedikuar për ata që duan të mbeten sadopak shqiptarë dhe nuk e kanë mundësinë as për vete dhe as për fëmijët e tyre. Këtu hyn shërbimi ynë, apo ai i “Vatrës”, apo i qeverive shqiptare, apo të gjitha shoqatave dashamirëse shqiptare. Duhet plane konkrete, duhet politika të mirëfillta, duhet, pse jo, të ketë shumë iniciativa të shkëlqyera si ajo e librave nga Qendra e Botimeve për Diasporën. Të mos harrojmë se edhe ata libra nuk kanë vlerë kur fëmijët nuk dinë si t’i lexojnë apo nuk dinë fare të flasin shqip. Fatkeqësisht, vëlla e motër në SHBA më së shumti flasin vetëm anglisht me njëri-tjetrin, dhe besoj në Itali vetëm italisht e kështu me radhë. E dhimbshme, por e vërtetë. Ndaj unë klubin “Flas Shqip” e shoh si një rrugë modeste për të ngadalësuar sadopak fenomenin sa më sipër.

” NUK MUND TË PRANOJA APO TË PRANOJ T’U MËSOJ FËMIJËVE TË GJAKUT TIM KUNDREJT NJË PAGESE GJUHËN TONË TË SHTRENTË, PËR TË CILËN HERONJTË TANË KANË DHËNË JETËN. ATA DHANË JETËN, NE NUK U DASHKA TË JAPIM DISA ORË VULLNETARE NË JAVË?!! ”



***Si mund të bëhen pjesë e këtij misioni shqiptarët që jetojnë në komunitete të tjera në SHBA, por që nuk kanë mundësi të ndjekin fizikisht klasat tuaja?***

Unë mendoj se gjuha e huaj nuk mësohet online, pasi pikë së pari fëmija do të duhet të mësojë si të hapë gojën për të shqiptuar një shkronjë apo një tjetër. Nga ana tjetër, unë mendoj se qëllimi i klubit është që fëmijët të kenë bashkim dhe komunikim mes njëri-tjetrit, po kështu dhe prindërit. Por klubi mund të shërbejë duke hapur modelin e tij kudo si dhe të përçojë eksperiencën e tij sipas parimit: *Në çdo shtëpi shqiptari të flitet shqip dhe çdo prind shqiptar të jetë një mësues i shqipes.* Këtu po e mbyll me fjalët e stërgjyshit tim Hajredin Fratari, Dëshmor i Pavarësisë, i cili së bashku me stërgjyshen Sabrete Vila Frashëri lanë Stambollin ku ishin edukuar në Akademinë

e Robert College, më i vjetri kolegji amerikan në Stamboll, dhe hapën në shtëpinë e tyre të parën shkollë shqipe në Mallakastër. Në çastet para pushkatimit nga Haxhi Qamilistët ai nuk harroi të përmendë gjuhën shqipe që e donte aq shumë: **“Shqiptarët kanë gjuhën e nënës për të folur shqip, zemrën e babës për të luftuar si burrat dhe jetën e tyre, atë që i duhet për atdheun.”** Veprat tona këtu, në vendin më demokratik të botës, më duken kaq modeste në krahasim me aktet e rilindësve tanë, që janë dhe do të mbeten burrat më të shquar shqiptarë pas më të madhit Skënderbe që vdiq me amanetin e bashkimit në gojë. Dhe si për të ndjekur amanetin e tij, puna jonë nuk do të ndalet asnjëherë, pasi as ka pasur dhe as do të ketë bashkim më të fortë sesa ai që vjen nga gjuha e njëjtë që flasim së bashku.



Nga AURELA KONDURI

# GJUHA SHQIPE SI GJUHË AMTARE

DHE GJUHA SHQIPE SI GJUHË E ORIGJINËS/  
GJUHË E TRASHËGUAR

## Entela Tabaku

### UNIVERSITETI I UPPSALA-S, SUEDI

Kanë kaluar tashmë pesëmbëdhjetë vjet që kur në Universitetin e Uppsala-s u hap kursi i parë i shqipes si gjuhë e huaj, që ofron jo vetëm trajnim të aftësive gjuhësore, por edhe njohje me elemente të kulturës dhe letërsisë shqipe. Meqenëse është i vetmi kurs në nivel universitar në të gjithë Skandinavinë, si edhe falë faktit që mësimi zhvillohet online, gjatë këtyre viteve kursin e shqipes si gjuhë e huaj (30 kredite) e kanë përfunduar me qindra studentë, mes tyre edhe shumë studentë që e kanë shqipen gjuhë të origjinës. Para katër vitesh, Universiteti i Uppsala-s hapi edhe kursin për mësues të shqipes si gjuhë amtare (30 kredite), që u drejtohet si mësuesve aktualë që duan të kualifikohen, ashtu edhe atyre që duan të bëhen mësues të shqipes në Suedi. Mësimi i shqipes si gjuhë amtare zhvillohet rregullisht në Suedi, në çdo shkollë ku ka fëmijë shqiptarë. Termi “gjuhë amtare” është një term i përdorur masivisht në kontekstin e mësimin të gjuhës shqipe nga fëmijët e mërgatës. Këtu vijojnë disa vëzhgime mbi arsyet që e kanë nxitur këtë përdorim, si edhe mbi pasojat e këtij përdorimi, të vështruara me lentën e hulumtimeve më të fundit shkencore në këtë fushë.



## TERMI “GJUHË AMTARE”, NJË PERSPEKTIVË NGA LART

Arsyeja kryesore ka të bëjë me dëshirën për t’u dhënë fëmijëve të mërgatës, të lindur në troje joshqiptare, një përkatësi të qëndrueshme me atdheun dhe gjuhën amtare të prindërve. Mësimi i gjuhës amtare shndërrohet kështu në kordon ombelikal që ushqen dhe mban gjallë identitetin shqiptar të nxënësit. Përdorimi i termit “gjuhë amtare” në kontekstin e nxënies së shqipes në mërgatë nxitet jo vetëm për arsye patriotike, por edhe për arsye politike. Në Suedi, për shembull, duke e klasifikuar shqipen si gjuhë amtare për nxënësit me prindër shqiptarë, e përfshijmë atë në programe mësimore që favorizojnë mësimin e gjuhës amtare të financuar nga shteti bujtës. Edhe shtetet tona amë e përdorin për arsye politike; të gjithëve u intereson një numër sa më i madh folësish amtarë të shqipes, edhe nëse këta folës janë të brezit të dytë a të tretë të emigrantëve. Deri këtu, duket se ky përdorim i termit ka vetëm të mira: shqipes i jep prestigj, fëmijëve u jep identitet dhe përkatësi. Atëherë, pse jo?



Në arsyetimin e mësipërm bie dukshëm në sy perspektiva nga lart poshtë: perspektiva e prindit përkundrejt fëmijës, e shtetit përkundrejt individit. Po të ndalemi dhe ta kundrojmë çështjen nga poshtë lart, nga perspektiva e fëmijës, vëmë re se mësimi i shqipes *si gjuhë amtare* u jep atyre jo vetëm identitet dhe përkatësi, por edhe i ngarkon me barrën e pritshmërisë dhe përgjegjësisë së njohjes së shqipes siç njihet gjuha amtare. Madje jo vetëm me njohjen, por edhe me ruajtjen e gjuhës shqipe. Pritshmëria dhe përgjegjësia munden me qenë nxitje e mëtejshme zhvillimi, por për t’u bërë të tilla duhet të jenë të realizueshme. Domethënë, pritshmëria që fëmija i lindur në mërgatë ta flasë shqipen si gjuhë amtare duhet të jetë e realizueshme dhe e mundshme. Vetëm kështu fëmijës mund t’i ngarkohet përgjegjësia për ta folur shqipen si gjuhë amtare.

PRITSHMËRIA QË FËMIJA I LINDUR NË MËRGATË TA FLASË SHQIPEN SI GJUHË AMTARE DUHET TË JETË E REALIZUESHME DHE E MUNDSHME. VETËM KËSHTU FËMIJËS MUND T’I NGARKOHET PËRGJEGJËSIA PËR TA FOLUR SHQIPEN SI GJUHË AMTARE.

A mund ta zotërojë shqipen si gjuhë amtare një fëmijë i lindur jashtë trojeve amtare të shqipes? Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje duhet më parë t’i përgjigjemi pyetjes: Çfarë e karakterizon një folës të gjuhës amtare? Zotërimi i një gjuhe si gjuhë amtare shënon shkallën më të lartë të njohjes së një gjuhe si në vetëdijen popullore, ashtu edhe në hulumtimet shkencore. Krahasimet, studimet, pikënisjet zënë fill gjithmonë me folësin e lindur të një gjuhe, *the native speaker*. Instinktivisht, të gjithë e kuptojmë cila është gjuha jonë amtare: është ajo në të cilën nuk kemi dyshime, ajo që na i plotëson në mënyrë të përkryer nevojat e komunikimit në raport me nivelin e shkollimit.

“Si e mbërrin fëmija këtë zotërim të shkëlqyer?”, ka qenë gjithmonë një pyetje së cilës janë përpjekur t’i përgjigjen hulumtuesit, sidomos për shkak se duke kuptuar sekretin e këtij zotërimi, mund të ndihmohen edhe ata që e mësojnë një gjuhë

si të dytë. Dy janë faktorët vendimtarë. Së pari mosha e hershme. Për t’u bërë gjuhë amtare, një gjuhë duhet të mësohet në vitet e para të jetës. Fëmijët e mërgatës e plotësojnë këtë kusht, meqenëse këta fëmijë, ashtu si edhe ata që rriten në troje amtare, zakonisht bien herët në kontakt me gjuhën e familjes. E megjithatë, edhe pse e plotësojnë kushtin e moshës së hershme, gjuha e fëmijëve të mërgatës të të gjitha etnive shfaq mangësi gjuhësore në shumë fusha: në fjalor (Polinsky & Kagan, 2007), në klasifikimin e gjinisë (Polinsky, 2008), në kohë, në aspekt dhe në mënyra (Montrul, 2002; Lynch, 2003; Silva-Corvalán; 2006; Polinsky, 2008), në paradigmat e rasave (Polinsky & Kagan, 2007), në raportin midis rasave dhe rendit të fjalëve në fjali (Song, O’Grady, Cho, & Lee, 1997), në fjalitë fylluese (O’Grady et al, 2011; Kim, 2001), në lidhjen midis kryefjalës dhe kallëzuesit (Bolonyai, 2007), në përemrat refleksivë (Song, O’Grady,

Cho, & Lee, 1997; Kim, Montrul & Yoon, 2009), në shënimin e kundrinorit (Montrul, 2004; Montrul & Bowles 2009) etj. Siç shprehet Montrul (2016: 41):

Because the vast majority of heritage speakers grow up in a situation of **subtractive bilingualism**, their language abilities and the structure properties of their heritage language show differences when compared to the grammatical abilities of their parents and of age-matched peers in their home countries.

Kjo ndodh, sepse, përkrah moshës, gjuha amtare kërkon edhe plotësimin e një kushti të dytë. Faktori i dytë është *input*-i gjuhësor që merr fëmija në këtë moshë të hershme, domethënë gjuha e prindërve dhe e familjes. Meqenëse, në përgjithësi, të gjithë njëvjeçarët, pavarësisht nëse banojnë në Shkodër apo në Stokholm, janë të rrethuar nga familja e vet, duket sikur mjafton që familja të flasë shqip dhe kushti i *input*-it është plotësuar. Por kjo tezë nuk qëndron. Hulumtimet tregojnë se brezi i parë i emigrantëve, brenda disa viteve nga emigrimi, fitojnë karakteristika në gjuhën amtare që nuk janë tipike të kësaj gjuhe. Në literaturën shkencore ky fenomen njihet si *attrition* (gërryerje, tretje) e gjuhës. “As parent’s length of residence increases, some of them may experience attrition” (Montrul, 2016: 239). Madje, ka studime që vërtetojnë fenomenin e gërryerjes edhe tek emigrantë të rritur, të cilët e kanë nxënë gjuhën amtare në kushte të njëgjuhësisë

dhe e kanë përdorur gjatë si gjuhë të vetme (Dussias, 2004; Tsimpli, Sorace, Heycock, & Filiaci, 2004).

Po japim një shembull gërryerje nga folësit e shqipes në brezin e parë të emigrantëve shqiptarë në Suedi. Ndërkohë që folësit e shqipes në trojet amtare alternojnë pa mëdyshje përdorimin e kohës së pakryer dhe kohës së kryer të thjeshtë, të kushtëzuar që në fëmijëri nga një zgjidhje e vetëkuptueshme për këdo që ka shqipen si gjuhë amtare mes aspektit të pakryer (*isha*) dhe aspektit të kryer (*qeshë*), ky alternim zbehet tek emigrantët, sa më shumë përdorin suedishten. E pakryera ia lë vendin gjithmonë e më shumë kohës së kryer të thjeshtë, edhe atëherë kur veprimet ndodhin njëkohësisht: *qeshë në punë kur më thirre!* Dallimi aspektual midis dy kohëve perceptohet si joqenësor, si i dorës së dytë. E pakryera dhe e kryera e thjeshtë nisin e ndihen si sinonime, sa më gjatë që folësit e shqipes jetojnë në kontekstin e gjuhës suedeze, larg trojeve amtare. Mjafton, për shembull, të shfletosh përkthime të brezit të parë, nga suedishtja në shqip, dhe gjen tekste ku dallohet qartë mungesa e alternimit të këtyre kohëve dhe ku dallimet aspektuale zgjidhen me shprehje të tipit *zakonisht* ose me ndihmën e *ndërkohë*, ashtu siç e zgjidh gjuha suedeze. Arsyeja është e thjeshtë, folja në gjuhën zotëruese të ambientit, suedishtja, nuk e ka kategorinë e aspektit. Si koha e pakryer (*isha*), ashtu edhe koha e kryer e



thjeshtë (*qeshë*) shprehen në suedisht me të njëjtën kohë që quhet *preteritum*, me të njëjtën formë foljore *var*. Përdorimi i përditshëm i kësaj forme në suedisht e tret dalëngadalë, në mënyrë të pavetëdijshme, dallimin edhe në shqipen e folësit të brezit të parë. Kuptohet, ky folës vazhdon ta njohë këtë formë kur e dëgjon të përdorur, por nuk e ka më aktive në gjuhë. Si rrjedhim, një zgjedhje e vetëkuptueshme për folësin e gjuhës në trojet amtare, tretet për folësin e gjuhës amtare në mërgatë.

I tillë është *input*-i gjuhësor i brezit të dytë. Edhe ne vetë mësuesit “vuajmë” nga gërryerja e shqipes, jo se bëjmë diçka gabim, por sepse është një proces i natyrshëm dhe i pashmangshëm. Me kalimin e kohës, ndjesia e gjuhës e humbet atë cilësinë e prerë të gjuhës amtare që e di krejt qartë si thuhet dhe si nuk thuhet. Toleranca gjuhësore rritet

dhe pranon edhe konstrukte që nuk janë të natyrshme për një folës të trojeve. Një *input* i tillë gjuhësor, si edhe futja graduale gjithnjë e më zotëruese në vetëdije e gjuhës së vendit, bën që fëmijët e mërgatës, edhe pse e mësojnë shqipen herët, nuk e arrijnë dot nivelin e moshatarëve të vet në trojet amtare të shqipes. Domethënë janë, por edhe nuk janë folës amtarë. Janë folës të trashëguar:

In a sense, heritage speakers are native speakers, because they start the acquisition of the heritage language early as native speakers but later undergo language shift. While some aspects of their language show age-appropriate and native-like attainment, others are not fully acquired in childhood (incomplete acquisition or acquisition without mastery” or manifest regression (attrition). (Montrul, 2016: 208)



Sigurisht, nxënia e gjuhëve është individuale dhe mbërritja e një niveli amtar nuk është e pamundur. Montrul (2016: 210) vazhdon më tej se po t'u krijohen kushtet e përshtatshme, me një përdorim aktiv të gjuhës në shoqëri dhe me mësimin në shkollë, edhe folësit që e trashëgojnë gjuhën mund të bëhen plotësisht të rrjedhshëm dhe, në disa raste, të padallueshëm nga folësit e trojeve amtare në shumë aspekte të gramatikës së tyre.

### SHQIPJA SI GJUHË E ORIGJINËS, PËR NJË NDËRRIM PERSPEKTIVE

Për sa kohë përdorim termin “gjuhë amtare” për shqipen e fëmijëve të lindur në mërgatë, do të jemi të detyruar të flasim për mangësitë e kësaj gjuhe, sepse, nga perspektiva e gjuhës amtare, shqipja e fëmijëve të mërgatës është një gjuhë e mangët. Nëse nisim t'i bëjmë llogaritë në minus, në minus do të mbetemi. Si e shohim dikë që nuk e flet mirë as gjuhën amtare? Si vlerë e munguar.

Por, nëse e ndërrojmë perspektivën dhe e shohim shqipen e fëmijëve të lindur jashtë trojeve amtare si gjuhë të origjinës (*lingua d'origine*) / gjuhë të trashëguar (*heritage language*), do t'i bënim llogaritë në plus. Shqipja e fëmijëve të mërgatës do të ishte një arritje, vlerë e shtuar e individit, sukses, pavarësisht nivelit të zotërimit. Kjo do t'i çlironte fëmijët nga kompleksi i mosnjohjes së gjuhës amtare. Ndërrimi i paradigmes do të rriste vetëbesimin e fëmijës dhe mënyrën si e shohin të tjerët.

Ndërrimi i perspektivës do të ndihmonte edhe në didaktikën e mësimin të shqipes në mërgatë. Siç e pamë më sipër, nxënia e gjuhës së origjinës/ gjuhës së trashëguar nuk i ngjan nxënies së gjuhës amtare; por nuk i ngjan as nxënies së gjuhëve të tjera. Trifonas *et al* (2014) shënojnë se gjuha e origjinës nuk mësohet as si mësohen gjuhët e dyta, as si mësohen gjuhët e huaja. Vetëdijesimi i mësuesve për këtë problematikë mund të ndihmojë në zgjedhjet e tyre pedagogjike dhe kështu, ndërrimi i paradigmes do të ndikonte në punën e drejtpërdrejtë me fëmijët. Duke studiuar karakteristikat e nxënies së gjuhës së origjinës, mësuesit do të mbështetnin më mirë dhe më me rezultat zhvillimin e shqipes te fëmijët.

Nga perspektiva shoqërore, njohësit e shqipes si gjuhë e origjinës/ gjuhë e trashëguar ndoshta nuk janë ata që do ta ruajnë shqipen. Ky mision i shenjtë u përket atyre që e flasin shqipen në trojet amtare. Por njohësit e shqipes si gjuhë e origjinës/ gjuhë e trashëguar kanë misione të tjera të rëndësishme:

- janë përkthyesit që na mungojnë sot, ata që njohin shqipen dhe e përkthejnë në gjuhën amtare të vendit bujtës;
- janë përçuesit e besueshëm të vlerave të kulturës shqiptare;
- janë lobuesit e interesave shqiptare në politikat e huaja.

Vetëm fëmijët që nuk ndihen në faj për mosplotësimin e pritshmërisë së gjuhës amtare, do të gjejnë dhe do të trashëgojnë pasurinë e vlerave të origjinës me vetëbesim dhe gëzim jete.



Nga TEUTA TABAKU

# UDHËTIM DYGJUHËSOR

PËRVOJA E NJË NËNE SHQIPTARE NË BARI

” KUR JETA TË ÇON  
NË VENDE TË REJA, AJO  
GJITHMONË OFRON  
MUNDËSI PËR TË MËSUAR  
DHE PËR T’U RRTUR NË  
SHUMË DIMENSIONE. KJO  
ËSHTË HISTORIA E NJË  
NËNE SHQIPTARE NË BARI,  
UDHËTIMI JETËSOR I SË CILËS  
KA KALUAR PËRMES SFIDAVE  
DHE SUKSESEVE. ”



Duke lënë pas vendlindjen e saj ajo ndoqi ëndrrat për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për veten dhe familjen. Në këtë rrëfim, ndan përvojën e saj si nënë, farmacistë, dhe aktiviste për ruajtjen e kulturës shqiptare në diasporë, duke ritheksuar rëndësinë e shkollës shqipe për fëmijët me origjinë shqiptare kudo janë në botë.



“PËRSHËNDETJE!

QUHEM MATILDA KRUTI, KAM LINDUR NË DIVJAKË DHE KAM JETUAR ATJE DERI NË MOSHËN 18 VJEÇARE. JAM NJË NGA ATA SHUMË STUDENTË QË JANË LARGUAR NGA VENDI I TYRE PËR T’U ARSIMUAR, ME BINDJEN QË NJË DITË DO KTHEHEN NË VENDLINDJE PËR TË DHËNË KONTRIBUTIN E TYRE, POR NUK JANË KTHYER MË SEPSE KANË PARË QË PËRTEJ SHQIPËRISË EKZISTOJNË SHOQËRI KU MJAFTOJNË AFTËSITË INDIVIDUALE PËR T’U REALIZUAR, SHOQËRI KU JO PATJETËR DUHET TË JESH BIRI APO MIKU I DIKUJT PËR TË FITUAR NJË KONKURS APO NJË VEND PUNE.”



Aquile di Seta” po hapte shkollën e parë shqipe në Bari. Nuk kam pritur por kam kontaktuar menjëherë me presidenten e shoqatës, znj. Aurela Hasku dhe kam regjistruar djalin në shkollë.

Në 23 tetor 2021 Mattia ishte një nga 12 nxënësit e parë që filluan shkollën shqipe. Hapja e shkollës shqipe në Bari ishte realizimi i një ëndrrë për mua sepse unë jam krenare për prejardhjen time, dhe dëshiroj që fëmijët e mi po ashtu të ndjehen krenar e të njohin vendin, gjuhën, kulturën e traditat tona.

\* \* \*

Shkolla shqipe në Bari është falas, në dispozicion të komunitetit tonë në Bari e rrethinat përreth tij, falë punës së palodhur e vullnetare të mësueseve tona të mrekullueshme,

presidentes së shoqatës, grupit koordinues, dhe të gjithë miqve tanë italianë që na kanë ndihmuar për ambientet e shkollës.

Që nga ai moment u bëra pjesë e shoqatës dhe pasi pashë se çfarë pune madhështore bëhej, vendosa të isha pjesë aktive e kësaj skuadre fantastike e të jap kontributin tim për këtë projekt që e kemi të gjithë shumë për zemër. Tani jam një nga dy koordinueset e shkollës dhe koordinojmë punën e mësueseve me grupin drejtues të shoqatës dhe me prindërit e nxënësve.

Është një rol të cilit, bashkë me kolegen time Selvina Vuka, i dedikojmë kohë dhe energji, por e bëjmë me shumë dëshirë dhe bindje se çdo sakrificë ia vlen kur dëgjojmë fëmijët të lindur këtu në Itali, shumë nga familje të përziera shqiptare e italiane, të flasin, lexojnë e recitojnë në Shqip.

Jam diplomuar në universitetin e Barit, në fakultetin e Farmacisë, dhe punoj prej 9 vitesh si farmacistë. Puna ime më pëlqen shumë sepse në Itali farmacia është një nga dyert e para ku njerëzit trokasin për shqetësimet e tyre shëndetësore e të jep mundësinë të ndihmohet çdo ditë dikë. Arsye për të cilën e kam zgjedhur këtë profesion.

Në Bari njoha bashkëshortin tim, shqiptar, dhe krijuam familjen tonë të cilën Zoti e bekoj me dy fëmijë, një djalë: Mattia 10 vjeç, e një vajzë: Arba 4 vjeçe. Familja jonë, si shumë familje të tjera shqiptare, është integruar më së miri në shoqërinë italiane, por për ne ka

qenë gjithmonë e rëndësishme që fëmijët të mësonin gjuhën shqipe e për këtë arsye jemi munduar t’i mësojmë shqipen si gjuhë të parë. Ata komunikojnë shumë bukur në shqip me kushërinjtë e gjyshërit sa herë që ne shkonim me pushime në Shqipëri deri sa filluan arsimin parashkollor e shkollor këtu në Bari.

Pasi filluan arsimin në Itali fëmijët filluan të flasin gjithmonë e më pak shqip e të komunikojnë shqip me ta bëhej çdo ditë e më e vështirë.

Në shtator të vitit 2021, nuk po i besoja syve kur pashë në rrjetet sociale të Konsullatës Shqiptare se një shoqatë vajzash shqiptare “Le





Për këtë dëshiroj të falënderoj në radhë të parë mësueset për punën e palodhur e shumë të çmuar që bëjnë për çdo fëmijë, të gjitha ato vajza të shoqatës që e nxitën këtë iniciativë të mrekullueshme e vazhdojnë të punojnë për ta çuar përpara si një mision....

Falënderoj edhe të gjithë prindërit që besojnë në këtë projekt, që sakrifikojnë çdo të shtunë për t'i sjellë fëmijët në shkollë e që gjithmonë janë të gatshëm të angazhohen për aktivitetet e shumta që zhvillojmë në shkollë.

Shkolla shqipe nuk i mëson vetëm gjuhën e traditat tona fëmijëve tanë, por shërben edhe si urë lidhëse midis nesh si komunitet e falë saj kanë lindur shumë miqësi të mira.

“Le Aquile di Seta” tashmë janë kthyer në një pikë referimi për sa i përket komunitetit



SHKOLLA SHQIPE NUK I MËSON  
VETËM GJUHËN E TRADITAT  
TONA FËMIJËVE TANË, POR  
SHËRZEN EDHE SI URË LIDHËSE  
MIDIS NESH SI KOMUNITET E  
FALË SAJ KANË LINDUR SHUMË  
MIQËSI TË MIRA.




shqiptar në Bari e brenda saj ka plot vajza, nëna e gra të gatshme për të mbështetur, inkurajuar e ndihmuar.

I ftoj të gjithë shqiptarët, kudo ku ndodhen në Itali, të regjistrojnë fëmijët në shkollat shqipe sepse siç thotë një proverb i famshëm kinez: “Koha më e mirë për të mbjellë një pemë, është para 20 vitesh. Koha e dytë më e mirë është tani”!

Dua ta mbyll këtë rrëfim duke treguar diçka shumë personale:

“Të dëgjoja djalin tim teksa recitonte poezinë «Skënderbeu» të Ismail Kadaresë, apo vargjet “Gjuhës shqipe” të Mitrush Kuteli më ka dhuruar emocione të pa përshkueshme, emocione që ia uroj çdo prindi shqiptar në emigrim t’i provoj”!





Nga YLLKA LEZO

LIBRI

# “ALBANI NUK FLET SHQIP”

NJË MESAZH PËR RUAJTJEN E GJUHËS SHQIPE  
TE FËMIJËT E DIASPORËS

“KY LIBËR SYNON TË JETË  
MË SHUMË SE THJESHT NJË  
NARRATIVË; ËSHTË NJË THIRRJE  
PËR TË GJITHË PRINDËRIT DHE  
NJË APEL PËR TË MBAJTUR GJALLË  
TRASHËGIMINË TONË KULTURORE  
TE FËMIJËT ME ORIGINË  
SHQIPTARE NË DIASPORË.”



Në një kohë kur numri i familjeve shqiptare që jetojnë jashtë atdheut rritet me shpejtësi, nevoja për të ruajtur gjuhën dhe kulturën tonë kombëtare është bërë më e rëndësishme se kurrë. Nën këtë presion të fortë të globalizimit, ku identiteti shpesh sfidohet, Angjelina Marku ka ndërmarrë një nismë për t'i dhënë zë këtij shqetësimi me botimin e librit për fëmijë “Albani nuk flet shqip”. Ky libër synon të jetë më shumë se thjesht një narrativë; është një thirrje për të gjithë prindërit dhe një apel për të mbajtur gjallë trashëgiminë tonë kulturore te fëmijët me origjinë shqiptare në diasporë. Autorja me një pasion të madh për letërsinë

dhe kulturën shqiptare, ka krijuar një vepër që synon të sensibilizojë prindërit, për t'i bërë të kuptojnë rëndësinë e mësimin të gjuhës shqipe për fëmijët e tyre, veçanërisht për ata që jetojnë në vende të huaja. Shtysa për ta krijuar këtë libër? Keqardhja kur takon prindër që e konsiderojnë gjuhën shqipe si diçka të panevojshme për fëmijët e tyre. “Më vjen keq që ata nuk janë të vetëdijshëm për rëndësinë dhe përparësitë që sjell njohja e gjuhës së nënës,” thotë ajo. “Ky libër është një përgjigje ndaj atij perceptimi, një mënyrë për t'u treguar se gjuha shqipe është një pasuri që duhet ruajtur dhe kultivuar” shprehet ajo.



Angjelina Marku lindi me 16 korrik 1968 në Gjakovë. Ka përfunduar shkollën e lartë pedagogjike "Bajram Curri" në qytetin e lindjes dhe ka qenë e angazhuar për disa vite si punonjëse e organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe si mësimdhënëse. Shkruan prozë dhe poezi. Ka marrë pjesë në shumë orë letrare dhe në disa konkurse letrare në të cilat është shpërblyer me çmime.

Është anëtare e klubit letrar "Gjon Nikollë Kazazi" në Gjakovë, e Lidhjes së Krijuesve Shqiptarë në Mërgatë si dhe e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Krijuesve Shqiptarë në Austri "Aleksander Moisiu" me seli në Vjenë, ku dhe jeton bashkë me familjen, bashkëshortin dhe dy fëmijë.

[www.angjelinamarku.eu](http://www.angjelinamarku.eu)

## ANGJELINA MARKU

### Albani nuk flet shqip



Tregim i shkurtër për fëmijë  
Vjenë, 2024



Frymëzimi për këtë libër lindi në një orë letrare në Vjenë, ku Marku ishte e ftuar të fliste me nxënësit që ndjekin mësimet në gjuhën shqipe. Ajo ndau me ta emocionin e krijimit, duke zhvilluar një tregim që u pëlqye shumë. Ky moment i veçantë e bëri atë të kuptonte se ky mesazh kishte nevojë për të qenë më i gjerë dhe më i qartë. Duke e thjeshtuar dhe zgjeruar tekstin, Marku ka krijuar një narrativë që ka për qëllim të kapë zemrat e fëmijëve dhe të rritë dëshirën për të mësuar gjuhën e tyre amtare.


“Thjesht, është mrekulli,” thotë ajo kur flet për punën me fëmijët. Puna me ta i sjell asaj një gëzim të veçantë, një ndjenjë që asnjëherë nuk e kishte përjetuar si shkrimtare. Ajo dëshiron që fëmijët të kuptojnë se gjuha e nënës është një dhuratë, një çelës që hap dyert e kulturës dhe identitetit shqiptar.

Mesazhi kryesor i librit “Albani nuk flet shqip” është një thirrje e fuqishme për prindërit.

“Mësoni të vegjlit ta duan gjuhën tuaj, flisni me ta sa më shumë që të jetë e mundur,” thekson ajo, duke nënvizuar se njohja e gjuhës amtare do t’u japë fëmijëve mundësinë për të kontribuar në të ardhmen. Ajo beson se një fëmijë që e do gjuhën e tij është një fëmijë që do të mbajë gjallë kulturën tonë.

Marku është e bindur se roli i librave është thelbësor për ruajtjen e gjuhës dhe kulturës. “Katalizatori kryesor që mban gjallë gjuhën dhe kulturën është libri,” thotë ajo me pasion, duke inkurajuar të gjithë shqiptarët, kudo që ndodhen, të lexojnë dhe të investojnë në librat që nxisin dashurinë për gjuhën e tyre.

Reagimet për librin e saj kanë qenë emocionuese dhe përtej pritshmërisë. Ajo shpreh mirënjohje për mbështetjen e komunitetit dhe lexuesve, të cilët e kanë përkrahur në këtë nismë. “Më kanë bërë të lumtur!” thotë ajo, duke shprehur që ky libër do të ndikojë pozitivisht tek të rriturit dhe fëmijët e tyre, duke kontribuar kështu në ruajtjen e kulturës shqiptare në diasporë.



Angjelina Marku aktualisht është duke punuar në projekte të tjera të lidhura me fëmijët, duke shpresuar se do të vazhdojë të inspirojë dhe inkurajojë brezat e rinj në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës së tyre. Me librin “Albani nuk flet shqip”, ajo ka krijuar një shkëndijë për të nxitur dashurinë për gjuhën shqipe dhe ka filluar një diskutim të rëndësishëm për rëndësinë e identitetit kulturor në diasporë. Kjo vepër është një kontribut i çmuar për ruajtjen e identitetit tonë dhe një thirrje për çdo shqiptar që të mbajë gjallë gjuhën dhe kulturën e tij, pavarësisht se ku ndodhet në botë.

# ANGJELINA MARKU

## Albani nuk flet shqip

Tregim i shkurtër për fëmijë  
Vjenë, 2024



Kush është autorja Angjelina Marku?

Angjelina Marku u lind më 16 korrik 1968, në Gjakovë. Ka përfunduar shkollën e lartë pedagogjike “Bajram Curri”, në qytetin e lindjes, dhe ka qenë e angazhuar për disa vite si punonjëse e organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe si mësimdhënëse. Shkruan prozë dhe poezi. Është anëtare e klubit letrar “Gjon Nikollë Kazazi” në Gjakovë, e Lidhjes së Krijuesve Shqiptarë në Mërgatë, si dhe e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Krijuesve Shqiptarë “Aleksandër Moisiu” në Austri, me seli në Vjenë. Aty ku dhe jeton bashkë me familjen, bashkëshortin dhe dy fëmijë.

Ndër botimet kryesore të saj janë:

- Dimri i Shekullit” (2018, Kosovë/Begjikë),
- “Winter of the century” (2020, SHBA),
- “Kohë për veten” (2020, Kosovë/Begjikë),
- “Tempo para mi alma” (2020, SHBA),
- “Time for myself” (2020, SHBA),
- “Shtyje hënë” (2021, Kosovë/Begjikë).

”

Makina u ndal para shtëpisë. Babai, nëna dhe motra zbritën dhe të lumtur u nisën drejt derës së oborrit. Para se babai të hapte derën u shfaq gjyshja që e përqafoi fort të birin. Albani s’donte të zbriste. Skuqur si diell nuk dilte nga automjeti. Sytë i kishte të mbushur me lot. Ishte i vetmi që nuk dinte shqip. Ato pak fjalë në gjuhën e emrit që i kishin vënë nuk i mjaftonin të komunikonte. Sa shumë i kishte dashur ato pesë shkronja, që në këto çaste e tradhtonin. I turpëruar për emrin që gjithmonë e kishte bërë krenar e shikonte motrën e tij, e cila nuk fliste bukur, por fliste dhe kënaqej me gjyshërit.

- Çka po pret Alban, pse nuk del? - i tha e ëma prapë në gjuhë të huaj, bile me shumë gabime. Djali u bë shumë nervoz. Si i çmendur doli prej makinës e shkoi tek gjyshja që i kishte hapur krahët për ta shtrënguar nipin me emrin më të bukur në botë.

- I veçanti im! I shtrenjti i nënës! Sa shumë të dua shpirt! Zemra e gjyshes! - i fliste ajo.

”

Djali pak a shumë i kuptoi vetëm dy fjalitë e fundit.



MUSTAFË KRASNIQI  
MIRADIJE BERISHA  
ARTA EMIRI

# SHKRIMTARËT E VEGJËL TË DIASPORËS

RUBRIKË KUSHTUAR KRIJIMEVE TË FËMIJËVE NË DIASPORË,  
ME QËLLIM MOTIVIMIN E TYRE PËR TË KRIJUAR NË GJUHËN SHQIPE



**BURIM DHE LIRA HISENI**

## Rrënjët që lulëzojnë

Kur nata bie, kujtoj vendin larg  
Aromën e tokës, nën qiellin e zjarrtë  
Unë dhe ti, motër, një yll dhe një varg  
Zemra na rreh me një ritëm të qartë.

Në gjuhën e nënës, një këngë po rri  
Është shpresë dhe mall, si era që fshin  
Ti më shtrëngon dorën, unë ndjej ngrohtësi  
Dhe brenda këtij malli, gjejmë një strehim.

Malli s'na tret, as largësia s'na ndal,  
Kujtimet rrënjët i lidhin përjetë  
Si dy zogj që qajnë, por s'dinë të ndal'  
Në çdo fjalë, gjendet një shpresë e qetë.


BURIM DHE LIRA HISENI, SHKOLLA SHQIPE, ZVICËR



**KLEA HOTI BEQIRI**

## "Fshati përtej liqenit"

Është 11 vjeç, ka lindur në qytetin e Lundit në Suedi dhe jeton në Bromma, Stokholm. Është nxënëse e klasës së pestë në shkollën "Norra Änby" në Stokholm dhe mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare e ndjek me mësuese Arta Emiri. Klea, përpos leximit shkruan edhe tregime dhe ka marrë pjesë në garat e novelës të organizuara nga shkolla ku mëson. Ka fituar çmimin e parë me tregimin për Malvën "Fshati përtej liqenit" dhe me fabulën "Kush mundohet arrin".



Isha pak e shqetësuar, por e ndiqja në mënyrë të pavullnetshme. Filluam të futeshim në liqen.

Kur kishim arritur një distancë të mirë, kanoja filloi të lëkundej, ajo filloi të fundosej. Papritur, gjyshi ra në ujë. Ai i shkelmoi këmbët me dhunë dhe luftoi për të qëndruar lart. Në fund, gjyshi nuk rezistoi dhe ngadalë u fundos.

– Jo! – bërtita dhe shpërtheva në lot dhe u ula. Ndihej si një përjetësi. Por unë po shkoja në shtëpi. Fillova të bëja *paddling*, ishte dy herë më e vështirë pa gjyshin.

Por cila rrugë ishte e drejtë? Në cilën mënyrë duhet të lundroj? Fyti m'u mbush me lot, por pata një shans dhe vazhdova përpara.

Pas një kohe të mirë mbërrita në një breg, por nuk ishte i njëjti breg që lamë, ishte një tjetër. "Thjesht, nuk mund të bëhet më keq!", mendova.

Në mes të të gjithave, filloi të binte shi. U struka poshtë një peme për t'u mbrojtur nga shiu dhe më në fund më zuri gjumi.

Koha kaloi dhe shkoi.

U zgjova nga një zhurmë e lehtë nga pylli. Ishte një njeri, ajo u duk e sjellshme. Ajo filloi të ecte drejt meje dhe erdhi pranë.

– Nga je ti? – më tha.

– Unë... Uhh unë nuk jam nga këtu gjithsesi.

– Mund të vish në shtëpinë time nëse do, – tha ajo.

– Quhem Rio, si quhesh?

– Eeh emri im është Malva, – iu përgjigja unë

Filluam të ecnim. Ecëm për një kohë të gjatë, më në fund arritëm në një fshat të vogël, ishte plot me njerëz, njerëz paqësorë.

Ditë, javë dhe muaj kaluan. Po ndjehesha mirë, të gjithë ishin të sjellshëm. Por gjyshi nuk u kthye kurrë më.

- A po vjen Malva?

Ishte gjyshi që bërtiste. Dielli shkëlqente dhe ishte një ditë e bukur pranvere. Kisha ndaluar për të lidhur lidhësen e këpucëve.

- Po, po vij! – bërtita unë.

Do të bënim një kanoen në liqenin e pyllit të gurtë. Ishte liqeni i preferuar i gjyshit.

Ai shkoi dhe tërhoqi mbi kanoen e tij të vjetër, nën të cilën kishte një dërrasë me katër rrota mbi të, në mënyrë që të ishte më e lehtë për t'u tërhequr.

Kur mbërritëm në liqen, gjyshi e hoqi kanoen nga dërrasa.

Liqeni shkëlqente në diell dhe pemët lëkundeshin ngadalë me erën.

- Më ndihmo ta tërheq kanoen në ujë! - thirri gjyshi.

Ngadalë zbrita te gjyshi dhe fillova të mbaja.

- Oh jo, harruam xhaketat e shpëtimit në makinë! – psherëtiu gjyshi.

- Mund t'i marrësh ato Malva?

-Po! - thashë dhe fillova të ecja.

Por, kur mbërrita në makinë, ata nuk ishin aty. Kërkova dhe kontrollova, por në fund m'u desh të kthehesha te gjyshi.

– Nuk ishin atje, – thashë unë.

– Atëherë do të na duhet të shkojmë pa jelekë pra, me siguri do të jetë mirë, – tha gjyshi dhe filloi të ecë drejt kanoes.

VJOSA SHALA

## Magjia dhe bukuria e vjeshtës

Vjeshta, stina e tretë, është stina më e bukur dhe magjike e vitit. Ngjyrat e ndryshme që zbukurojnë pemët me nuanca të arta, portokalli dhe të kuqe krijojnë peizazhe që të lënë pa fjalë. Shpesh unë, prindërit e mi, vëllai dhe motra shëtisim në natyrë, duke shijuar qetësinë dhe bukurinë që kjo stinë ofron. Unë e adhuroj mbledhjen e gjetheve, që kanë rënë për toke dhe krijimin e veprave artistike prej tyre, duke u ndjerë gjithnjë e më e frymëzuar nga natyra. Vjeshta na sjell ditë më të freskëta, shi të shpeshtë dhe net më të gjata, të cilat na bëjnë të vlerësojmë më shumë ngrohtësinë e shtëpisë. Është koha kur shumë fruta, si rrushi, arrijnë pjekurinë e tyre dhe janë gati për vjelje. Vjeshta është një stinë e begatshme, që na dhuron dardha, mollë, rrush dhe një bollëk të vërtetë frutash dhe perimesh. Zogjtë shtegtarë largohen drejt vendeve të ngrohta për t'u kthyer sërish në pranverë. Me të gjitha dhuratat e saj, vjeshta është një periudhë e veçantë që na bën të ndiejmë më shumë lidhjen me natyrën dhe njëkohësisht të përgatitemi për qetësinë dhe ngrohtësinë e dimrit që po afrohet.

Vjosa Shala, kl. 4, Vjenë

## Skënderbeu Gjergj Kastrioti

Skenderbeu me shpat në dorë  
qysh i vogël 8 vjeçar turqit me veti  
e kanë marrë me luftë shpatën e kanë  
marrë veç për ta me luftë kur u  
rit e qun ushtar e gradun e ban  
të par' o'j zani në Ballkan tu luftue  
si Luan.

Kujtojmë lavdinë historike  
të heroit tonë kombëtar  
Gjergj Kastrioti – Skënderbeu.



Punoi: Elina Berisha

Kujtojmë lavdinë historike të heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu

## Skënderbeu

Skënderbeu me shpatë në dorë  
qysh i vogël 8-të vjeçar  
turqit me veti e kanë marrë,  
me luftë shpatën e kanë marrë  
veç për ta me luftë,  
kur u rit e qun ushtar  
e gradun e ban të par'  
i dul zani në Ballkan  
t'u luftue si luan.

ELINA BERISHA



“ 1 SHTATOR 2024, NJË DITË E BUKUR DHE FESTIVE PËR NXËNËSIT E MËSUESVE QEFERE DHE VAXHID SEJDIU, TË SHKOLLAVE SHQIPE KU ATA PUNOJNË DHE VEPROJNË NË ZVICËR, NË EKSKURSIONIN E TYRE NË CONNY LAND, NË LIPPERSWIL, TË KANTONIT TË THURGAU-T. ”

Nga VAXHID SEJDIU

# SHKOLLAT SHQIPE NË ZVICËR

VITI I RI SHKOLLOR I NXËNËSVE NIS ME EKSKURSION

Ky vit i ri shkollor për nxënësit e shkollave shqipe në Zvicër nisi me një ekskursion në Conny Land, në Lipperswil, të kantonit të Thurgau-t. Në këtë aktivitet të veçantë për fillimin e shkollës fëmijët u shoqëruan nga mësuesit Qefsere dhe Vaxhid Sejdiu, të ndihmuar edhe nga prindërit e shkollave shqipe ku ata punojnë dhe veprojnë në Regensdorf, Affoltern, Dällikon, Rümlang, Fahrweid, Neuenhof, Spreitenbach, Wetzikon, Rütli, Volketswil, Schwerzenbach, Uster dhe në Pfäffikon.

“Ishte një ditë e bukur, një ditë festive. Buzëqeshjet e fëmijëve, gëzimin dhe kënaqësinë që përjetuan në këtë shëtitje besoj se do ta mbajnë mend gjatë. E gjithë

kjo ishte meritë e mësuesve të këtyre pikave shkollore dhe e prindërve Mrika Limoni, Vlora Hasanaj, Sherif Dakaj, Ramiz Hasani, Iba e Nehat Bulica, të cilët i shoqëruan nxënësit në këtë aktivitet shkollor. Po ashtu një mirënjohje e veçantë për donatorët, të cilët ndihmuan materialisht në realizimin e këtij aktiviteti, Merita Rifati, Shqipe dhe Florim Hajdari, si dhe pronari i firmës ‘Durmo Tours’, z. Ismail Behluli”, thotë Vaxhid Sejdiu, organizator i aktivitetit. Nisja u bë në orën 8 të mëngjesit nga pika shkollore në Spreitenbach duke i tubuar me radhë nxënësit sipas shkollave, me qëllim që të arrinin sa më shpejt në vendin e caktuar. Rruga deri në Conny Land të





“ KËNAQËSI E VEÇANTË TË SHOHËSH SHTATËDHJETË E TRE NXËNËS, TË CILËT, EDHE PSE JETOJNË LARG ATDHEUT, GJATË TËRË VITIT MUNDOHEN TA MËSOJNË SA MË MIRË GJUHËN SHQIPE. ANGAZHIMI I TYRE NË MËSIM DHE NË MANIFESTIMET SHKOLLËRE DËSHMON QARTË SE KY ESKURSION ISHTE NJË DHURATË E BUKUR PËR TA.

Lipperswil-it dukej e shkurtër, sepse gjatë gjithë kohës nxënësit qeshnin, këndonin dhe argëtoheshin në mënyra të ndryshme. Ajo që shihej dukshëm ishte gëzimi i këtyre fëmijëve për të qenë së bashku në një aktivitet të lirë. Edhe pse nxënësit ishin nga pika të ndryshme shkollore, konkretisht prej dy kantoneve (të Argau-t dhe të St. Cyrih-ut), si dhe pothuajse nga të gjitha trojet shqiptare në atdhe, nuk vërehej ndonjë ndryshim mes tyre. Shihej qartë një afërsi, të gjithë flisnin një gjuhë, këndonin shqip dhe natyrisht i gëzoheshin shëtitjes me të cilën po fillonin vitin e ri shkollor, duke risjellë në bisedat e tyre edhe kujtimet nga pushimet verore në vendlindje.

Alea H., Tana, Lina L., Nora, Arianita, Ariani, Aurisa, Elsa, Eni, Riani, Eduani, Gent K., Flori K., Melodi, Ajla, Lina S., Era, Rina, Shera, Erina, Jara, Gent H., Diari, Dijar S., Rona, Nejla, Fiona, Lindi, Noriku, Edioni, Altini, Eljona, Anika, Rumesa, Erina, Anesa, Dijar Sh., Flokarta, Endriti, Learti, Arti, Dua, Ideali, Amra, Agoni, Alea R., Ariani B., Riduani, Bleroni, Aroni, Vlora, Medina, Dritoni, Nafija, Arjan Th., Luiza, Rejana, Eliesa, Lijana, Jora, Tara, Agita, Agim, Kasemi, Neriti, Gent H., Eroni, Ardina, Alisha, Lorini, Katalea, Anila etj. kanë një kërkesë për të gjithë fëmijët shqiptarë, që edhe ata t’i ndjekin mësimet në shkollën shqipe, sepse pa gjuhën shqipe nuk ka kuptim e ardhmja e fëmijëve shqiptarë.

“Një gjë e kemi thënë në të gjitha takimet tona me prindërit shqiptarë, me përfaqësuesit e institucioneve tona të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, si dhe me ato vendore zvicerane se dallimi mes atyre që i ndjekin mësimet në gjuhën shqipe dhe atyre të cilët rrinë duarkryq larg shkronjave të alfabetit shqip padyshim është shumë i madh”, thotë mësuese Qefsera Sejdiu. Vlen të theksohet se këtë vit shkollor nxënësit e shkollave shqipe janë pajisur me kohë edhe me tekstet shkollore të nivelit të dytë krahas atyre të nivelit të parë, kështu që mund të themi se nxënësit e nivelit të parë (klasat I–III) dhe të nivelit të dytë (klasat IV–VI) i pret beteja e radhës. Një vit plot

përkushtim dhe angazhim për ta mësuar sa më mirë gjuhën amtare. E kemi thënë në të gjitha rastet se ruajtja e gjuhës amtare të fëmijët shqiptarë është obligim i të gjithëve, prandaj këtë rrugëtim medoemos duhet ta bëjmë së bashku. “Duke i falënderuar të gjithë ata të cilët ishin pjesë e kësaj shëtitjeje të shkollave shqipe, mbesim me shpresë se për të gjithë të tjerët, të cilët për hir të moshës (nga klasa I–III apo edhe të klasës IV) nuk arritën të vijnë me ne, do të jemi së bashku në shëtitjet e radhës dhe në manifestimet shkollore”, shprehen organizatorët. Suksese nxënës. Në mërgim, buzëqeshjet tuaja janë rreze dielli.



Nga YLLKA LEZO

# SHKOLLA E KURSE SHQIPE

KURSI I MËSIMIT PLOTËSUES TË GJUHËS SHQIPE  
"FRANG BARDHI" IRAKLIO, KRETË, GREQI

Në vitin 2017, mësueset Klarita Selmanaj dhe Jerida Kulla, në bashkëpunim me Shoqatën e Shqiptarëve të Iraklios së Kretës në Greqi, filluan Mësimin Plotësues të Gjuhës Shqipe në ambientet mësimore të shkollës fillore nr. 12, të lagjes "Poro" të qytetit të Iraklios.

Hapja e këtij kursi që përbëhej nga 24 nxënës, shënoi fillimin e kurseve të Mësimin Plotësues të Gjuhës shqipe për ishullin e Kretës.

Në nëntor të vitit 2020, për shkak të pandemisë, mësueset filluan mësimet online nëpërmjet platformës "Zoom". Kursi u emërtua "Frang Bardhi" dhe vazhdon të funksionojë gjer më sot.

Nxënësit që ndjekin mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në këtë kurs janë nga zona të ndryshme të Greqisë, Amerikës, Gjermanisë etj. Mësimet bëhen çdo të shtunë, nga ora 18:00 – 20:30.

Kursi ka tri klasa të niveleve të ndryshme.



Një nga projektet më të bukura dhe të rëndësishme të Qendrës së Botimeve për Diasporën është botimi i përrallave për fëmijë në dy gjuhë. Çdo fëmijë ka të drejtën e natyrshme të rritet me magjinë e përrallave, qofshin ato të lexuara apo të rrëfyera. Këto tregime fantastike dhe personazhet e tyre udhëtojnë përmes imagjinatës, duke shoqëruar fëmijët nëpër vende dhe epoka të ndryshme.

Me këtë projekt, fëmijët shqiptarë që jetojnë në Itali, ose ata që e njohin gjuhën italiane, mund të përfshihen në një aventurë unike. Përmes këtij udhëtimi dygjuhësh, ata kanë mundësinë të lexojnë, mësojnë dhe krahasojnë përrallat në shqip dhe italisht, duke forcuar kështu njohuritë në të dyja gjuhët. Ky projekt nxit lidhjen me rrënjët dhe promovon një mësim të këndshëm e të natyrshëm për fëmijët e diasporës, duke i çuar më pranë traditave dhe kulturave të tyre.

# KLASIKËT DYGJUHËSH

UDHËTIME PARALELE NË BOTËN E PËRRALLAVE  
PËR FËMIJËT NË DIASPORË

**Ejani në këtë udhëtim fantastik dygjuhësh të zbulojmë së bashku titujt e kësaj kolane.**

Si fillim e nisim me fjalorin dygjuhësh (sepse do të na duhet për të mësuar fjalë që nuk i dimë).

(shkarko falas këtu)

<https://qbd.gov.al/qendra-e-botimeve-per-diasporen-publikon-falas-online-fjaloret-dygjuhesh-per-femije/>



## ROSAKU I SHËMTUAR

Kjo përrallë klasike ngre pyetje në lidhje me ngacmimin, diskriminimin dhe rëndësinë e të qenit i vërtetë me veten. Rosaku i shëmtuar dukej shumë ndryshe nga vëllezërit e motrat e tij, të cilët talleshin me të dhe e trajtonin keq, sepse ai nuk u ngjante atyre. Ai do të donte të ishte i bukur si mjellmat që pa duke fluturuar në qiell.

### FJALË INTERESANTE

Ignoravano – Nuk përfillin  
Sprezzante – Me përçmim  
Fattezze – Tiparet  
Scarseggiare – Pakësohet  
Angolo – Cep



## KËSULËKUQJA

Në versionet e saj fillestare që vijnë nga Franca dhe Italia, përralla quhej “Historia e gjyshes” dhe në të nuk kishte kapuç të kuq dhe ujku ishte në fakt një ujku. Në disa versione, ai ishte një përbindësh. Është një përrallë mjaft e frikshme, por me një fund interesant – vajza e vogël arratiset duke përdorur zgjuarsinë e saj.

### FJALË INTERESANTE

Abbracciarla – Përqafoj  
Traggito – Shteg  
Inghiottito – Hëngri ose gëlltiti  
Divorarti – Kollofti  
Balzo – Hungëri

### FJALË INTERESANTE

Scintillante – E shndritshme  
Rattristati – Mërzitëshin  
(trishtoheshin)  
Ciglio – Skaj  
Spadaccini – Shpatar  
Abili – Shkëlqyer



### FJALË INTERESANTE

Colmi di gioia – Gëzim i madh  
Elargito – Dhuruar  
Fusi – Furka  
Rovi – Shkurre (ferra)  
Cortigiani – Oborrtarë

## PITER PANI

Kjo përrallë klasike ngre pyetje në lidhje me ngacmimin, diskriminimin dhe rëndësinë e të qenit i vërtetë me veten. Rosaku i shëmtuar dukej shumë ndryshe nga vëllezërit e motrat e tij, të cilët talleshin me të dhe e trajtonin keq, sepse ai nuk u ngjante atyre. Ai do të donte të ishte i bukur si mjellmat që pa duke fluturuar në qiell.

## BUKUROSHJA E FJETUR

Kjo përrallë klasike ngre pyetje në lidhje me ngacmimin, diskriminimin dhe rëndësinë e të qenit i vërtetë me veten. Rosaku i shëmtuar dukej shumë ndryshe nga vëllezërit e motrat e tij, të cilët talleshin me të dhe e trajtonin keq, sepse ai nuk u ngjante atyre. Ai do të donte të ishte i bukur si mjellmat që pa duke fluturuar në qiell.

## HIRUSHJA

Në një nga variantet që daton në vitin 7 p.e.s., Hirushen e gjejmë në Greqi me emrin Rodopi. Në këtë version, një shqiponjë vjedh një nga sandalet e saj teksa ajo është duke u larë dhe ia dërgon mbretit të Memphis, i cili është aq i mahnitur nga bukuria e formës së sandaleve saqë i dërgon njerëzit e tij për të gjetur të zonjën e sandales. Pasi gjendet, ai e bën Rodopin mbretëreshën e tij. Megjithatë historia e Hirushes është universale.

Versionet e historisë së Hirushes nuk kanë ardhur vetëm nga Greqia e lashtë, por nga e gjithë bota. Tregime të ngjashme mund të gjenden në Kinë, Japoni, Vietnam dhe Evropën mesjetare. Versioni i parë i shkruar në Evropë erdhi nga Italia, por në vitin 1697 një nga versionet më të njohura të Hirushes u shkrua nga Charles Perrault në Francë.



### FJALË INTERESANTE

Sorellastre – Bijat e njerëz  
Cenere – Hi  
L'acconciatura – Stolisje (e flokëve)  
Lucertola – Hardhucë  
Follemente – Çmendurisht



## PINOKU

“Aventurat e Pinokut” është një prej librave klasikë më të njohur në letërsinë mbarëbotërore, shkruar prej autorit italian Karlo Kolodi. Kjo kryevepër letrare është përkthyer në mbi 260 gjuhë dhe dialekte në mbarë botën duke e shndërruar Pinokun në një figurë të njohur globalisht.

Historia e tij magjepsëse dhe personazhet e paharrueshme kanë rrembyer imagjinatën e lexuesve në mbarë botën, duke forcuar statusin e saj si një klasik letrar.

### FJALË INTERESANTE

Grillo – Bulkth  
Falegname – Marangoz (zdukthar)  
Imbroglioni – Mashtrues  
Burattinaio – Marionetist  
Incrocio – Kryqëzim

# PROVOJMË NJOHURITË

Pasi të keni lexuar udhërrëfyesin “Berati”, ju do të keni mësuar shumë fakte interesante për qytetin e një mbi një dritareve, banorët e tij dhe historinë mbi 2400-vjeçare.

*Jeni gati të provoni njohuritë tuaja? (Në fund kontrolloni përgjigjet.)*

**1. Ura e Goricës është një prej monumenteve më të bukura të qytetit. Sa harqe ka?**

- a) Dy harqe
- b) Pesë harqe
- c) Shtatë harqe
- ç) Dhjetë harqe

**2. Flamuri dhe stema e qytetit kanë si simbole:**

- a) Emblemën e Bushatllinjve
- b) Emblemën e Topiajve
- c) Emblemën e Balshajve
- ç) Emblemën e Muzakajve

**3. Në cilin vit Berati është njohur nga UNESCO si trashëgimi botërore e njerëzimit?**

- a) Në vitin 1998
- b) Në vitin 2000
- c) Në vitin 2008
- ç) Në vitin 2015



**4. Gjeni si flasin beratasit.**



- |                |     |                   |
|----------------|-----|-------------------|
| a) vëllai      | apo | a) 1. vëllaj      |
| b) bear        | apo | b) 1. behar       |
| c) ndodh       | apo | c) 1. ndoth       |
| ç) qy/qo       | apo | ç) 1. ky/kjo      |
| d) bredh       | apo | d) 1. vrapoj      |
| dh) qoromidhe  | apo | dh) 1. tjegull    |
| e) kukumal     | apo | e) 1. grumbull    |
| ë) lëvore veze | apo | ë) 1. gollovexhgë |
| f) bërthackë   | apo | f) 1. bërthamë    |

**5. Cila nga shprehjet e dhëna më poshtë nuk është beratase?**

- a) Gur, gur bëhet mur.
- b) Si këmbët e dhisë.
- c) Kam inat po nuk kam takat.
- ç) Kur s'më bën nder, mos më bëj qeder!
- d) Qenke këmbëz e urës ti!



**Përgjigjet: 1 c); 2 ç); 3 c); 4 a) 1, 4 b), 4 c) 1, 4 ç), 4 d), 4 dh), 4 e), 4 ë) 1, 4 f); 5 a)**



**Horizontalisht**

- 3.** Përdorëse prej metali që nxehtet me mënyra të ndryshme dhe shërben për të hekurosur rrobat.
- 4.** Lënda e lëngshme që përdoret për të ngjyer sende etj.
- 5.** Kafshë e egër mishngrënëse, me trup të madh e të rëndë, të mbuluar me qime të ashpra, me ngjyrë të murrme a të bardhë.
- 7.** Vegël e posaçme me një fushë të ndarë në dymbëdhjetë pjesë dhe me akrepa që shërben për të matur kohën.
- 8.** Lëng i trashë e shumë i ëmbël, në ngjyrë të qelibarit, që e bëjnë bletët me nektarin e luleve.

**Vertikalisht**

- 1.** Kafshë e egër mishngrënëse, e ngjashme me qenin, me qime të përhimë në të verdheme, me veshë të drejtë e me majë.
- 2.** Koha prej dymbëdhjetë muajsh.
- 3.** Nuk e mbaj më mend dikë a diçka, nuk e kujtoj dot; më ka dalë nga mendja një gjë që e kam ditur.
- 4.** Bimë me kërcell të hollë e të njomë në formë fijesh në ngjyrë të gjelbër që mbulon lëndinat, që mbillet në kopshtet rreth shtëpive etj.
- 6.** Dëshirë e nevojë e theksuar që kemi për të ngrënë.

**PËRGJIGJET:**

3. hekuri 4. boja 5. ariu 7. ora 8. mjaltë 1. ujku 2. viti 3. harroj 4. bar 6. uria

**Horizontalisht**

- 2.** Veshje e njeriut për këmbët kur ecën jashtë.
- 3.** Veprimi sipas kuptimeve të foljeve peshkoj, peshkohet.
- 4.** Mbulesa e sipërme e një ndërtese a e një shtëpie, zakonisht e pjerrët dhe e përbërë prej një skeleti, mbi të cilin vendosen tjegulla etj.
- 6.** Pellg shumë i madh natyror ose artificial, zakonisht me ujë të ëmbël, që është i rrethuar nga të gjitha anët me tokë.

**Vertikalisht**

- 1.** Gropëz e vogël që e kanë disa njerëz në mjekër ose që u bëhet në faqe kur qeshin ose pikla të vogla të dallueshme në lëkurën e fytyrës.
- 2.** Qumësht i mpiksuar me tharm, pak i thartë.
- 3.** Nëna dhe babai kundrejt fëmijëve.
- 5.** Fill a shufër shumë e hollë prej metali, që përdoret për të lidhur ose për të mbajtur diçka.

**PËRGJIGJET:**

2. këpucë 3. peshkim 4. çati 6. liqen 1. quka 2. kos 3. prind 5. tel

O K R T I

*Veshje e sipërme e trashë, me mëngë ose pa mëngë, që bëhet me thurje dhe që është zakonisht e hapur përpara.*

M U Ë B P L L

*Shpend i butë a i egër me krahë të shkurtër, me pendë të bardha ose ngjyrë hiri në të kaltër që mbahet si simbol i butësisë dhe i paqes.*



QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, SI INSTITUCIONI PËRGJEGJËS NË SHQIPËRI PËR MBËSHTETJEN E SHKOLLAVE SHQIPE NË DIASPORË PËRMES BOTIMEVE, SYNON TË MUNDËSOJË PËRMES KËSAJ REVISTE NJË KOMUNIKIMIN MË TË MIRË ME RRJETIN E SHKOLLAVE SHQIPE, NË VEÇANTI ME MËSUESIT E GJUHËS SHQIPE KUDO KU JAPIN NDIHMESËN E TYRE NËPËR BOTË.

## FLASIM SHQIP

